



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional
“ Hoteleri Turizëm” me profile “Hoteleri” dhe “Agjenci Udhëtimesh”
Kolegji Universitar “I Biznesit”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc Shpresim DOMI

Prof. Asoc. Edmond KADIU

Shtator / 2024

Tabela përmbledhëse për programin e studimit me karakter profesional në
“Hoteleri-Turizëm” me profile Hoteleri”dhe “Agjenci Udhëtimesh”

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “ I Biznesit
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Studimeve të Larta Administrative
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi me karakter profesional në: “Hoteleri-Turizëm”, me profile “Hoteleri”dhe “Agjenci Udhëtimesh”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 383, datë 08.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 (pestë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 7PAE / 2PAK 2023-2024 10 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 7 studentë 2023-2024 10 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar i Biznesit ka në përbërje të tij 3 (tre) njësi kryesore (fakultete);

1. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike;
2. Fakulteti i Ekonomisë;
- 3. Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale;**

Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale përbëhet nga 2 (dy) njësi bazë (departamente):

1. Departamenti i Studimeve të Larta Administrative;
- 2. Departamenti i Studimeve të Larta Teknike;**

Programi i studimit është licensuar sipas Urdhërit të MAS Nr. 383, datë 08.07.2022. Programi i studimit me karakter profesional në: “Hoteleri-Turizëm”, me profile “Hoteleri” dhe “Agjenci Udhëtimesh” ofrohet nga Departamenti i Studimeve të Larta Administrative, i Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale. Ky departament ka në organikën e tij 7 staf akademik, ndër të cilët 5 me kohë të plotë dhe 2 me kohë të pjesshme. Ky program studimi i nivelit 5 të KSHK, synon pikërisht formimin e specialisëve me kompetenca në fushën prioritare të zhvillimit të vendit, sic është Turizmi. Ky program studimi ka kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike me kohë të plotë (4 semestra) në përfundim më sukses të së cilit studenti fiton 120 kredite. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë profesionale në: “Hoteleri-Turizëm”, me profile “Hoteleri” dhe “Agjenci Udhëtimesh.

Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit me karakter profesional në: “Hoteleri-Turizëm”, me profile “Hoteleri” dhe “Agjenci Udhëtimesh për vitin akademik 2023-2024 është 11 Staf gjithsej nga të cilët 10 janë PAE dhe 1 janë PAK.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”, Kolegji Universtar “I Biznesit” ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit me karakter profesional, në “Hoteleri-Turizëm”, me profile “Hoteleri” dhe “Agjenci Udhëtimesh”. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Kolegji Universitar “I Biznesit”, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: **Prof. As. Edmond Kadiu** dhe **Prof. As. Shpresim Domi**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Anilda Beqiraj.

Në punën për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm (RVJ), grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Diplomë profesionale në “Hoteleri-Turizëm”, me profile “Hoteleri” dhe “Agjenci Udhëtimesh”, kaloi në disa hapa. Fillimisht grupit të vlerësimit të jashtëm ju vu në dispozicion dosja e plotë e vetëvlerësimit me raportin e vlerësimit të brendshëm dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për këtë proces. Pas studimit të dosjes GVJ hartoi kuadrin e qartësimeve dhe saktësimeve të informacionit të paraqitur në dosje.

Për plotësimin dhe konkretizimin e këtyre informacioneve GVJ iu vunë në dispozicion dy ditë për të zhvilluar një vizitë në institucion, e cila kishte një agjendë të përcaktuar qartë.

Vizita në institucion u zhvillua në datat 1 dhe 2 shkurt 2024 .Gjatë vizitës u zhvilluan takime me dekanin, përgjegjës të departamentit, GVB dhe stafin e brendshëm dhe të jashtëm për këtë program, studentët dhe zyrat kryesore të këtij kolegji.

Gjatë këtyre takimeve GVJ u njoh më tej me organizimin dhe drejtimin e programit të studimit, burimet financiare, punën dhe përpjekjet e stafit, përpjekjet për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, me mbështetjen e studentëve, respektimin e të drejtave të tyre, infrastrukturën dhe logjistikën në funksion të programit. Në vijim GVJ hartoi raportin.

MEMO

Përgjigjet mbi Draft RVJ e Programit të Studimit profesional në “Hoteleri Turizmi”

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft-Raportin e programit profesional në ‘Hoteleri Turizmi’ vijon përgjigjen si më poshtë:

Nr.	Fusha	Standard i	Kriteri	Gjetja e GVJ	Përgjigjet e GVB	Përgjigja Përfundimtare e GVJ
1	I	1	1	<i>Stafi akademik i angazhuar për mësime në këtë program studimi, rezultoni se në disa raste përputhja e kompetencave të tyre me profilet e programit nuk është e plotë. Në vazhdim, konstatohet se nuk ka një listë të miratuar të fushave akademike e kërkimore të njësive/ve përgjegjëse</i>	<i>Vlerësimi përfundimtar i Fushes I, është pozitiv por kriteri 1.1 i standardit I është vlerësuar "kryesisht", për faktin që sipas ekspertëve "Nuk ka një listë të fushave akademike të kërkimit nga njësia bazë, e cila edhe kështu siç është shkruar, nuk ka kuptim. Mendojmë që duhet të rishikohet.</i>	<i>Në bazë të Standartit I.1, kriteri 6, kërkon që Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Mbështetur në këqyrjen e dokumentacionit dhe vizitën në IAL, ky kriter nuk arrihet.</i>
2	II	2.1	2	<i>GVJ konstaton se programi i studimit është i organizuar në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015, VKM nr. 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019, megjithatë ka paqartësi në përmbajtjen e kurrikules. Kështu, duhet një ristrukturim dhe pasurim me lëndë që lidhen me profilet e</i>	<i>Fusha II, Standardi I.1. është vlerësuar "kryesisht", vetëm për faktin se ekspertët sygjerojnë se "duhet një ristrukturim dhe pasurim me lëndë që lidhen me profilet e programit. Ka paqartësi dhe ngjashmëri në përmbajtjen e syllabuseve. Ky është një program që zhvillohet 1 për herë të parë dhe kjo është një vërejtje</i>	<i>Kurrikula, dhe më konkretisht syllabuset e lendeve/moduleve janë pjesë thelbësore e cilësive së një programi studimi, pavarësisht nëse është në fillim apo në vazhdimësi. Në këto konstatuar që nuk arrihet të qartësohet dallimi në përmbajtjen e disa lendeve, nevojën e pozicionit në vitin e parë ose të dytë (shpërndarja në vite). Kështu, Në profilin</i>

				<p>programit. Ka paqartësi dhe ngjashmëri në përmbajtjen e syllabuseve të disa lëndëve. Kjo është analizuar më në thellësi në vlerësimin e kriterit 2, Standardi II.1.</p>	<p>qe i takon licensimit dhe jo esperteve te RVJ, te cilet mund të rekomandojne por jo te vleresojne mendimin e tyre. Prandaj vlerësimi "kryesisht" nuk ka lidhje me cilesine e implementimit te programit por me gijkimin e eksperteve për qellimin e programit dhe si i tillë nuk qendron.</p>	<p>Hoteleri ka paqartësi në dallimin e përmbajtjes si edhe emërtimet e lendeve "Hoteleri", "Ndërmarrje Hotelerie", "Shërbime Hotelerie dhe turistike". Ndërkohe "Ndërmarrje Hotelerie" syllabusi është i njëjtë me atë të lëndës "Menaxhim në Hoteleri" që zhvillohen në vitin e dytë të profili Hoteleri.</p>
3	II	2.4	3	<p>GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, të nivelit 5 të KSHK. Rezultatet e të nxënit, kompetencat e fituara në përgjithësi janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. GVJ konstaton se Raporti teori/ praktikë është 50:50, në përputhje me profilin e programit të studimit si një program jouniversitar 2 vjecar me karakter profesional. Nga verifikimii i dokumentacionit në dispozicion, nuk arrihet kufiri minimal prej 25% e programit i cili duhet ti dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion (sipas VKM Nr. 879, 18.12.2019). Është e nevojshme që në një afat të shkurtër kurrikula të ri-organizohet dhe përmbajtja e disa lëndëve të thellohet, qartësohet dhe</p>	<p>Standardi 2.4 është vlerësuar "kryesisht" sepse nuk evidentohet 25% i zhvillimit te mesimeve praktike, nderkohe qe pohohet se programi respekton raportin e ballancuar teori-praktike 50% me 50%. Ky pohim e ezauron plotesisht faktin se 25 % e programit jane mesime praktike dhe kete e kane te pasqyruar ne çdo syllabus te lendeve qe kishin ne dispozicion. Prandaj vlerësimi "kryesisht" nuk qëndron.</p>	<p>Konkluzioni dhe për rrjedhojë vlerësimi i Shkallës së përmbushjes së standardit, janë si pasojë e mos arritjes së kufirit minimal prej 25% e programit i cili duhet ti dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion (sipas VKM Nr. 879, 18.12.2019).</p>

				<i>shmangen ngjashmëritë.</i>		
4	II	2.5	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit</i>	<i>Sa i përket përditësimit në vazhdimësi, ky është një program i çelur rishtazi. Megjithatë, referuar marevshjeve me aktorët e tregut, promovimet në shkolla të mesme (pra maturanët), si edhe vëzhgimet e vazhdueshme me studentët, ky program studimi ka potencial për të qenë i përditësuar në vazhdimësi.</i>	<i>Standardi 2.5 është vlerësuar "kryesisht" sepse ndonese është bere promocion, nuk ka patur pjesmarrje ne diskutime te maturanteve. Ne fakt ne e konsiderojme nje vlerësim lapsus per arsye se te gjithe kriteret jane vlerësuar pozitivisht dhe se nuk rezulton te kete ndonje verejje qe i jep standardit vlerësimin "kryesisht" Prandaj edhe ky vlerësim nuk qendron. Nisur sa me sipër nuk ka kuptim qe Fusha II te vleresohet me "kryesisht".</i>	<i>GVJ shqyrton dhe analizon përgjigjen e GVB-së, dhe e vlerëson si të pranueshme, duke ndryshuar vlerësimin për shkalla e përmbushjes së standardit 2.5 në "Përmbushet plotësisht"</i>
5	V	5.3, dhe 5.4	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit dhe shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës</i>	<i>Institucioni nëpërmjet sekretarisë mësimore, dokumenton dhe administron në mënyrë të rregullt të gjithë informacionin dhe dokumentacionin me të dhënat e studentëve që ndjekin këtë program studimi nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Sugjerohet që sistemi PITAGORA që është në proces të vihet në punë sa më shpejt të jetë e mundur i cili do të lehtësonte menaxhimin e të dhënave dhe informacionit për studentët, gjë e cila do të garantonte siguri, lehtësi në verifikim, dhe transparencë.</i>	<i>Fusha V, vlersimi "kryesisht", mendojme qe eshte nje lapsus, sepse te gjithe standardet jane pozitivisht te vleresuara pavaresisht se standardi 5.3 dhe 5.4 kane marre velërësimi kryesisht, por vleresimi I tyre nuk ka asnje lidhje me ate qe kane pohuar vete ekspertët. Nese lexoni konkluzionin e standardit 1.2 te fushes I, kuptohet vetvetiu se ky vleresim eshte i gabuar. Ndersa për standardin 5.4, ky eshte thjesht sygjerim per tu berë me te ardhmen nëse giykohet e arsyeshme nga strukturat perkatese.</i>	<i>GVJ shqyrton dhe analizon përgjigjen e GVB-së, dhe e vlerëson si të pranueshme, duke ndryshuar vlerësimin për shkalla e përmbushjes të standardeve të fushes V në "Përmbushet plotësisht"</i>
6	IV	IV.1	Konkluzione	<i>GVJ vlereson se praktikat e KUB për angazhimin në programin e studimit</i>	<i>Ky është një konstatim dhe vlerësim jo korrekt. Gjykojmë se</i>	<i>GVJ në raport me përgjigjen e GVB_së mbi këtë fushë thekson se nga</i>

			<p>2 vjeçar "Hoteleri-Turizëm" e stafit akademik efektiv PAE. GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar konstatoi nevojën e rekrutimi të burimeve njerëzore, staf akademik efektiv PAE me background dhe fushë akademike-kërkimore Turizmi dhe Hotellerie. Staf efektiv PAE i cili është aktualisht i angazhuar me lëndë të rëndësishme të kurrikulës së programit të studimit programit të studimit 2 vjeçar "Hoteleri-Turizëm". Të cilët në backgroundin e tyre, si në bachelor apo edhe në nivel Masteri Shkencor nuk janë në përputhshmëri me drejtimin "Hoteleri-Turizëm". Duhet që drejtimin e tyre në studimet dhe kualifikimet në vazhdim në nivel Doktorature apo edhe post Doktorature ta kenë në drejtim të profilit "Hoteleri-Turizëm". Si pasojë edhe aktivitetin e tyre kërkimor e shkencor ta kenë në këtë drejtim. Shkas për këtë sygjërimi janë disa pedagogë staf akademik efektiv PAE të cilët nuk janë në përputhshmëri me profilin "Hoteleri-Turizëm" por që kanë mundësi të orjentojnë në vijim studimet e tyre dhe fushën e tyre të kërkimit në drejtim të profilit të "Hoteleri-Turizëm". Fakt ky i cili ndikon drejtpërdrejtë në</p>	<p>vlerësimi duhet parë.</p>	<p>shqyrtimi i CV ve të stafit akademik, vizita në institucion por edhe nga diskutimi me stafin efektiv PAE. GVJ konstaton se background et, fushat akademike-kërkimore të përgjithshme dhe specifike të anëtarëve të personelit akademik PAE që mbulojnë këtë program studimi nuk janë dominante e në përputhshmëri të plotë me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve e lëndëve të tyre. Prandaj edhe i qëndrojmë plotësisht konstatimeve dhe vlerësimin të kësaj fushe.</p>
--	--	--	--	------------------------------	--

				<i>cilësinë e këtij programi studimi.</i>		
7	IV	IV. 3	Konkluzione	<p><i>GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur kryesisht, kjo e konstatuar nga dokumentacioni në dispozicion, vizita me stafin dhe studentët e programi. Literatura bazë dhe ndihmëse e programit u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program. Por GVJ rekomandon një përditësim të literaturës më dinamike, Njëkohësisht sikurse është rekomanduar edhe në kriterin 2 Standardi III. 2, të evitohen e shmangen mbivendosjet e temave nga lëndë të tjera me literatura të njëjta në lëndë të ndryshme. Rasti i Temave të përsëritura të librit <i>Ekonomia e Turizmit</i> në përmbajtje të syllabusit <i>Politika Turistike</i>. Pra të sigurohet literature specifike sipas lëndëve</i></p>	<p><i>Ky është një konstatim dhe vlerësim jo korrekt. Gjykojmë se vlerësimi duhet parë. Autori i librit është personalitet në këtë fushë.</i></p>	<p><i>GVJ në raport me përgjigjen e GVB së mbi këtë standard të kësaj fushë thekson se një përditësim më dinamik të literaturës së viteve të fundit dhe sa më bashkëkohore pasi ajo e përfshirë në progrmet e disa lëndëve sidomos të turizmit janë botime të përpara 10 viteve. Njëkohësisht sikurse është rekomanduar edhe në kriterin 2 Standardi III. 2, të evitohen e shmangen mbivendosjet e temave nga lëndë të tjera me literatura të njëjta në lëndë të ndryshme. Rasti i Temave të përsëritura të librit <i>Ekonomia e Turizmit</i> në përmbajtje të syllabusit <i>Politika Turistike</i>. Janë lëndë me specifika programore të ndryshme.</i></p>

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Hoteleri-Turizëm”, me profile “Hoteleri” dhe “Agjenci Udhëtimesh”,

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Përkundrazi, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare pasi fusha në të cilën do të ofrohen kompetenca (Turizmi) janë koherente dhe të domosdoshme. Turizmi është prioritet kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afat-gjatë socio-ekonomik dhe kulturor të vendit. Ky program është në përputhje me kuadrin normativ (ligji për turizmin, ligji për investimet strategjike etj), si dhe Politikat kombëtare (pra., Strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit). <i>Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar te Biznesit.pdf</i> <i>Dok. nr.8 Studimi i tregut te punes.pdf</i> <i>A.1.8 Plani strategjik i zhvillimit të IAL Kolegji Universitar i Biznesit Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, më konkretisht, statuti, rregullorja e programit të studimi, evidentohet që është në përputhje me qëllimet, misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. Në statut shprehet se misioni i KUB është të formojë specialistë dhe shkenctarë të rinjë në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit. Ndëkohë ky program studimi i nivelit 5 të KSHK, synon pikërisht formimin e specialisëve me kompetencanë fushën prioritare të zhvillimit të vendit , sic është Turizmi. <i>Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar te Biznesit.pdf</i> <i>A.1.8 Plani strategjik i zhvillimit të IAL Kolegji Universitar i Biznesit Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i> <i>A.5.108 Dokumentet bazë për akreditim, dok. nr. 2, Rregullore e KUB,.pdf</i>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.</p>	<p>Ky program studimi është konform dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të institucionit (2021-2026), Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij. Në planin Strategjik të zhvillimit të institucionit shprehet qartë se ofrimi i arsimit profesional i këtij niveli është pjesë strategjike e zhvillimit të nëtejshme të institucionit. Po ashtu, në Statut, shprehet qartë se ky nivel studimi është pjesë e misionit të KUB dhe se është kompetent për ta ofruar një gjë të tillë (shiko neni 11). Ky program studimi është në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të tij (shiko neni 4, Statuti i KUB). Rregullorja e programit të studimit operacionalizon aspekte të strategjisë dhe statutit në terma konkret që e bëjnë këtë program studimi në përshtatje me këto dokumente të rëndësishme institucionale.</p> <p><i>Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar të Biznesit.pdf</i> <i>A.1.8 Plani strategjik i zhvillimit të IAL Kolegji Universitar të Biznesit Dok. nr.7 Rregullore e programit të studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Çelja e këtij program studimi është mbështetur në studim mbi tregun nëpërmjet të cilit janë marrë mendimet (pra janë intervistuar) aktorëve të interesuar drejtpërdrejt. Megjithatë mungon pjesëmarrja në këtë studim i maturantëve. Kjo do ishte një vlerë e shtuar për studimin duke qene se është një program studimi në ciklin e parë, dhe se maturantet janë ato që synojnë të regjistrohen.</p> <p><i>A.1.11 Studim i Tregut të Punës” për programin e studimit “Hoteleri-Turizëm”, Mars 2021, i përditësuar në periudhën shtator-tetor 2023.pdf</i> <i>A.5.109 Kopje e studimit të tregut nga ZSKK.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në “Hoteleri-Turizëm”, me profile “Hoteleri” dhe “Agjenci Udhëtimesh”, ofrohet nga Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale i cili përbëhet nga 2 (dy) njësi bazë (departamente):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Studimeve të Larta Administrative; 2. Departamenti i Studimeve të Larta Teknike; <p>Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale për vitin akademik 2023-2024 ka angazhuar gjithsej 29 staf akademik nga të cilët 12 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 17 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin:</p>

	Kualifikimi i stafit	Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale	
		PAE	PAK
	Prof.Dr	-	-
	Prof.Asoc	2	2
	Dr/PhD	3	1
	Msc	7	14
	Gjithsej	12	17

Nga se më sipër konstatohet se institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. Megjithatë, nga intervista me stafin, lidhur me kapacitetet profesionale të tyre (pra, jetëshkrimet të stafi akademik) të angazhuar për mësim-dhënie në këtë program, *rezulton se në disa raste përputhja e kompetencave të tyre me profilet e programit nuk është e plotë. Po ashtu, mungon lista e jetëshkrimeve në dosjen elektronike, e cila kufizon analizën në këtë drejtim. Megjithatë, eksperiencë në mësimdhënie dhe angazhimet në kërkime shkencore që janë në përputhje me fushën e veprimtarisë janë të mjaftueshme.*

Takimi me stafin gjatë vizitës në IAL.

Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Nga ekzaminimi i dokumentacionit rezulton se fusha e përgjithshme dhe specifike (pra., ajo e profileve) e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

Megjithatë, duhet theksuar se nuk ka një listë konkrete të miratuar të fushave akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse.

Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar te Biznesit.pdf
A.1.8 Plani strategjik i zhvillimit të IAL Kolegji Universitar i Biznesit Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf
Dok.

Konkluzione

Në tërësi, nga ekzaminimi i dokumentacioni të disponueshëm rezulton se KUB ofron programe studimi në përputhje me

	<p><i>misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare</i></p> <p><i>Megjithatë, stafi akademik i angazhuar për mësimdhënie në këtë program studimi, <u>rezulton se në disa raste përputhja e kompetencave të tyre me profilet e programit nuk është e plotë. Në vazhdim, konstatohet se nuk ka një listë të miratuar të fushave akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse</u></i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, dhe mobilitetit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit në dispozicion rezulton se ofrimi i këtij programi mundësohet nga ndërveprimi i strukturave të ndryshme të institucionit në termat e stafit, dhe administrimi. Kështu, rezulton e qartë ndarja e detyrave mes njësive të personelit akademik dhe administrativ, marrjes së përgjegjësisë përkatëse. Ky aspekt është jetësor duke konsideruar faktin se kurrikula është gjithmonë ndër-departamentore, ndër-fakultatore etj.</p> <p><i>A.1.13 Statuti i KUB, Rregullore e DSLA, Rregullore Programit të Studimit.pdf</i></p> <p><i>A.5.108 Dokumentat bazë për akreditim, dok. nr. 2, Rregullore e KUB,.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit,</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje mirëkuptimi me IAL të tjera (brenda dhe jashtë vendi) që kanë programe të ngjashme në fushën e turizmit. Po ashtu, nga dokumentet e vëna në dispozicion rezultojnë një numër i larë i marrëveshjeve me biznese që janë plotësisht në fushën e veprimtarisë së programit. Në total ky IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me 182 IAL, biznese, institucione publike dhe aktorë të tjerë të tregut.</p>

<p>aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p><i>A.1.17 Lista e institucioneve kompanive dhe subjekteve me të cilat KUB ka marrëveshje bashkëpunimi..pdf</i></p> <p><i>A.1.16 Marrëveshje bashkëpunimi me Lumsa University, Itali. Model.pdf</i></p> <p><i>A.1.15 Marrëveshje bashkëpunimi me UBT. Model.pdf</i></p> <p><i>A.1.18 Marrëveshjet e bashkëpunimit me këto kompani (Melia International Hotels, FAFA Group, Kalemi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje të posaçme dhe afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. Në total ky IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me 182 IAL, biznese, institucione publike dhe aktorë të tjerë të tregut</p> <p><i>A.1.17 Lista e institucioneve kompanive dhe subjekteve me të cilat KUB ka marrëveshje bashkëpunimi..pdf</i></p> <p><i>A.1.18 Marrëveshjet e bashkëpunimit me këto kompani (Melia International Hotels, FAFA Group, Kalemi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Krahas një procedure ekzistuese lidhur me praktikën mësimore edhe profesionale të studentëve, institucioni harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Kjo gjë shprehet në dok <i>A.1.21 Analizë e punës së DSLA për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023, fq.6.pdf.</i></p> <p><i>A.1.21 Analizë e punës së DSLA për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023, fq.6.pdf.</i></p> <p><i>A.1.20 Paketa e Praktikës Profesionale.pdf</i></p> <p><i>A.1.21 Analizë e punës së DSLA për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023, fq.5.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Institucioni ka struktura të ngritura lidhur me karrierën e studentëve, për të cilën ka një rregullore të dedikuar. Zyra e studentëve dhe Këshillimi të Karrierës ka funksion specifik në këtë drejtim. Po ashtu, nëpërmjet guidës studentore adresohet ky aspekt.</p> <p><i>Referencë:</i></p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së.</i></p>

	<i>A.5.107 Statuti i KUB; Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës Guida studentore.pdf</i>			
	<i>A.1.22 Lista e personaliteteve nga bizneset ne leksione te hapura. Ëorkshope..pdf</i>			
Konkluzione	<i>Mbështetur në marrëdhëniet e bashkëpunimit që KUB ka me institucione, kompani, palë të treta, dhe aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj garanton një aftësim profesional dhe cilësor të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit – statutit, rregullore e IAL, rregullore e programi të studimit, dhe rregullores së NJSBC rezulton se Institucioni e plotëson këtë kriter.</p> <p>KUB ka strukturë të dedikuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Pranë KUB është NJSBC e cila është krijuar me vendim Senati në vitin 2015. Kjo njësi harton dhe monitoron zbatimin e standardeve lidhur me procesin mësimor dhe atë shkencor. Po ashtu, me studentët, realizon çdo semestër pyetësin e vlerësimit të performancës së stafit akademik në proceset e mësimi.</p> <p><i>A.5.91 Dokumentet bazë për procesin e akreditimit, Dok. nr.16 Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.2 Rregullore e Kolegjit Universitar Te Biznesit.pdf</i></p> <p><i>A.1.8 Plani strategjik i zhvillimit të IAL Kolegji Universitar i Biznesit 2021-2026, Dokumentet bazë për akreditim dok nr. 5 fq 21-22 pika 5.2.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar te Biznesit.pdf</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e	Për këtë IAL ka struktura dhe procedura të dedikuara. Studentët janë të përfshirë në këtë proces nëpërmjet dhënies së opinionit dhe qëndrimeve ndaj stafit akademik dhe atij

<p>Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>administrativ të IAL-së. Kjo gjë realizohet çdo semestër nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të performancës së stafit akademik në proceset e mësimit.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së.</i></p> <p><i>A.1.24 Vendimi i SA "Për ngritje strukturash mbështetëse dhe emërimet përkatëse në KUB" Raporti Vjetor i KUB për vitin akademik 2021-2022, rregullore njsbc.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Konstatohet se IAL, krahas proceseve të vlerësimit të brendshëm, ai shfrytëzon dhe ato të jashtëm. Kështu, IQE dhe Grand Thorton janë pjesë e këtij procesi.</p> <p>Grand horton ka kryer auditim në aspektin financiar, ndërsa IQE në aspektin e marrjs së opinionit të studentëve lidhur me institucionin. Megjithatë mungon një vlerësim i jashtëm lidhur me aspekte më konkrete të akreditimit, apo vlerësimeve analitike e krahasuese.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së.</i></p> <p><i>A.0.1 Vendimin BA Nr. 03, datë 07.01.2022, (Për akreditimin periodik institucional) të Kolegjit Universitar të.pdf</i></p> <p><i>A.1.25 Raporti i IQE, dhe Grand Thorton.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>Mbështetur dhe në dokumenin e Analizës së punës së DSLA, krijohet bindja se institucioni përdor tregues të qartë të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. Megjithatë, duhet konsideruar rishikimi i treguesve të performancës së publikimeve shkencore, në të cilin kërkohet publikimi i të pakën dy punimeve shkencore në revista të indeksuara në SCOPUS apo web of Science. Gjykoj se është shumë u vështirë të arrihet. Vlen të theksohet fakti se IAL motivon stafin në këtë drejtim duke i mbuluar shpenzimet e publikimeve. Po ashtu, nuk është e qartë marrja e masave në rast mos arritje të objektivave të performancës.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së.</i></p> <p><i>A.1.26 Lista e stafit dhe botimet e realizuara për periudhën 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>A.1.21 Analizë e punës së DSLA për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023, fq.5.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Edhe pse në tërësi ky standard rezulton i përmbushur, është e nevojshme një rishikim i treguesve të performancës</i></p>

	<i>akademike për ti përcaktuar sa më real, dhe për më tepër, nuk është e qartë marrja e masave në rast mos arritje të objektivave të performancës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit janë të organizuara në lëndë në përputhje me Ligjin 80/2015 për arsimin e larë, dhe po ashtu është në përputhje me VKM nr. 41., dt. 24.01.2018, si edhe VKM nr. 879, dt. 18.12.2019. Dokumentat e vena në dispozicion (A.2.28 Planet mësimore për vitin akademik 2023-2024.pdf; A.2.37 Planet mësimore të programit të studimit “Hoteleri-Turizëm” për vitin akademik 2023-2024.pdf) është e qartë që Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module.</p> <p>Në planet mësimore të disponueshme, përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit. Ngarkesa në kredite është e shpërndarë respektivisht në 60 kredite për cdo vik akademik (pra., në total 120 kredite ECTS). Bazuar në dokumentat e disponueshme, cdo lëndë/modul ka të përcaktuar ngarkesën në kredite duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Njëkohësisht në planet mësimore përcaktohet qartë dhe në përputhje me VKM nr. 41., dt. 24.01.2018, si edhe VKM nr. 879, dt. 18.12.2019 (pika I, germa d, pika ii - për programet</p>

	<p>me karakter profesional), pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit.</p> <p>Njekohesisht ky aspekt qaresohet edhe ne nenin 8 te rregullores se programit te studimit.</p> <p><i>A.2.28 Planet mësimore për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.2.37 Planet mësimore të programit të studimit “Hoteleri-Turizëm” për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.5.101 Kurrikula dhe planet mësimore të programit “Hoteleri-Turizëm” Plani për shpërndarjen e pedagogëve.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>Bazuar në planet mësimore 2023-2024, për pjesën që është pasqyruar, në një gjykim të përgjithshëm, kurrikula e programit përmban lëndë të cilat arrijnë të formojnë profesionistë të mesëm me kompetencat e duhura.</p> <p>Megjithatë, nuk arrihet të qartësohet dallimi në përmbajtje e disa lëndëve, nevoja e pozicionit në vitin e parë ose të dytë (shpërndarja në vite). <i>Sidoqoftë, sugjerohet që në një të ardhme të afërt, në një afat kohor jo më shumë se një vit akademik, duke mos kaluar kufirin 20% ndryshim të kurrikulës, të përmirësohet shpërndarja e lëndëve përgjatë dy viteve studime dhe pasurimi me ato të lidhura ngushtë me profilet.</i></p> <p>Kështu, lënda Politikat turistike është më e arsyeshme të jetë në vitin e dytë pasi është shume e vështire të absorbohet nga studentët e vitit të parë. Kjo gjë vlen edhe për disa lëndë të tjera, dhe për të dy profilet, me synim pozicionimin e lëndëve të profilit në vitin e dytë. Gjykoj se është e nevojshme që të pasurohet kurrikula me lëndë të lidhur ngushtë dhe në terma më konkret me profilet e këtij program studimi siç është “Menaxhimi i Ushqimit dhe Pijeve” disa tema të së cilës trajtohen në lëndën “Shërbime Hotelerie dhe turistike”.</p> <p>Në profilin Hoteleri ka paqartësi në dallimin e përmbajtjes si edhe emërtimet e lendeve “Hoteleri”, “Ndërmarrje Hotelerie”, “Shërbime Hotelerie dhe turistike”. Ndërkohe “Ndërmarrje Hotelerie” syllabusi është i njëjtë me atë të lëndës “Menaxhim në Hoteleri” që zhvillohen në vitin e dytë të profili Hoteleri.</p>

	<p><i>A.2.28 Planet mësimore për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.2.37 Planet mësimore të programit të studimit "Hoteleri-Turizëm" për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.2.27 Syllabuse të lëndëve të semestrit të parë të vitit akademik 2023-2024 në programin "Hoteleri-Turizëm"..pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Objektiva të përcaktuar në këtë program studimi janë të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve.</p> <p>Konkretisht, në nenin 3, pika 1, dhe 2, të rregullores së programit të studimit janë qaresuar qëllimi, objektivat dhe kompetencat që mund të ftojnë në përfundim të këtij program studimi. Megjithatë, sikundër u theksua më lart, është e nevojshme që një afat kohor jo më shumë se një vit akademik, duke mos kaluar 20% e ndryshimi të kurrikulës, duhet që struktura e shpërndarjes së lëndëve dhe pasurimi i kurrikulës me lëndë më ngushtësisht të lidhura me profilet.</p> <p><i>Referencë:</i></p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së.</i></p> <p><i>Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e ekzaminuar, ky aspekt është plotësisht i arritur. Ngarkesa në kredite është e shpërndarë respektivisht në 60 kredite për cdo vik akademik (pra, në total 120 kredite ECTS). Bazuar në dokumentat e disponueshme, cdo lëndë/modul ka të përcaktuar ngarkesën në kredite duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p> <p><i>A.2.28 Planet mësimore për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.2.37 Planet mësimore të programit të studimit "Hoteleri-Turizëm" për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.2.27 Syllabuse të lëndëve të semestrit të parë të vitit akademik 2023-2024 në programin "Hoteleri-Turizëm"..pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimit të studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në</p>	<p>Në nenin 62, të Rregullores të KUB dhe nenin 5 të Rregulles të programit të studimit, janë përcaktuar kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit. Kriteri bazë është përfundimi me sukses i ciklit të arsimit të mesëm.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u kopnstatua se nuk ka studentë që gëzojnë status të veçantë, në këtë program studimi. Kuota të veçanta, janë përcaktuar nga departamenti dhe miratuar</p>

kuadin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	nga Senati për çdo vit akademik, por nuk ka pasur kërkesë për këtë program të studimit. <i>Dok. nr.2 Rregullore w Kolegjit Universitar Te Biznesit;</i> <i>Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit;</i> <i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i>			
Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ nuk gjeti dokumentacion referues që të shprehet për këtë kriter. <i>GVJ sugjeron, se KSLP duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim, pra të shprehet për programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi në Shqipëri apo më gjerë.</i>			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se KUB ka unifikuar kodet për cdo program studimi, ku nëpërmjet shkresës me nr 46 prot, datë 08.02.2023 i ka dërguar në MAS. Nuk ka marrë ende përgjigje mbi këtë çështje. <i>A.2.29 Kodifikimi me shkresën nr. 283, datë 30.06.2023 dërguar në MAS;</i> <i>Nga takimi me stafin e IAL-së.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se program i studimit është i organizuar në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015, VKM nr. 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019, megjithatë ka paqartësi në përmbajtjen e kurrikules.</i> <i>Kështu, duhet një ri-strukturim dhe pasurim me lëndë që lidhen me profilet e programit. Ka paqartësi dhe ngjashmëri në përmbajtjen e syllabuseve të disa lëndëve (shiko vlerësimin në kriteri 2, Standardi II.1).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi																																																							
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ për vlerësimin e këtij kriteri ju referua të dhënave tabelore të deklaruara në DVV, nga të cilat rezulton se KUB është i përbërë nga tre njësi kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Ekonomisë; 2. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike; 3. Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (KSLP); <p>Kolegji i studimeve të larta profesionale (KSLP) përbëhet nga 2 departamente (njësi bazë):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Studimeve të Larta Administrative (DSL A); 2. Departamenti i Studimeve të Larta Teknike; <p>Departamenti i Studimeve të Larta Administrative gjatë dy viteve akademike ka këto të dhëna:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj /grada</th> <th colspan="3">2022-2023</th> <th colspan="3">2023-2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>Gj</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>GJ</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>2</td> <td>0</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>0</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Mp</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>5</td> <td>2</td> <td>7</td> <td>5</td> <td>2</td> <td>7</td> </tr> </tbody> </table> <p>Pra njësia bazë plotëson kriteret ligjore sipas VKM Nr. 370, datë 26.04.2017.</p> <p><i>5. Aneksë tabela përmbledhese te RVB.A.2.30 Struktura e DSLA.pdf;</i></p> <p><i>A.2.31 Lista e stafit akademik të DSLA, tituj grada Rregullore e Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale, neni 4,.pdf</i></p>	Tituj /grada	2022-2023			2023-2024			PAE	PAK	Gj	PAE	PAK	GJ	Prof.Dr	0	0	0	0	0	0	Prof.As.	0	0	0	1	0	0	Dr/Phd	2	0	2	3	0	2	Msc	2	1	4	1	2	4	Mp	1	1	1	0	0	1	Në total	5	2	7	5	2	7
Tituj /grada	2022-2023			2023-2024																																																				
	PAE	PAK	Gj	PAE	PAK	GJ																																																		
Prof.Dr	0	0	0	0	0	0																																																		
Prof.As.	0	0	0	1	0	0																																																		
Dr/Phd	2	0	2	3	0	2																																																		
Msc	2	1	4	1	2	4																																																		
Mp	1	1	1	0	0	1																																																		
Në total	5	2	7	5	2	7																																																		
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin</p>	<p>GVJ konstaton se në departamentin e i Studimeve të Larta Administrative është 1 (një) personel Ndhmës akademik.</p> <p><i>5. Aneksë tabela përmbledhese te RVB.A.2.30 Struktura e DSLA.pdf;</i></p>																																																							

e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.									
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Në kuadër të programit të studimit, KUB ka përcaktuar një staf akademik me gradë shkencore Dr, si koordinator të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Ky koordinator është emërtuar me udhër të drejtuesit të departamentit për caktimin e koordinatorit të programit “Hoteleri-Turizëm”</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së.</i></p> <p><i>A.2.32 Urdhër i drejtuesit të departamentit për caktimin e koordinatorit të programit “Hoteleri-Turizëm”.pdf</i></p>								
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacioni dhe vizita në institucion, konstatohet se IAL-ja ka një organizimin dhe strukturë akademike, stafet akademike vlerësim dhe akreditim. Po ashtu, konstatohet se IAL-ja ka angazhuar nje personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj., si dhe një personel në rolin e koordinatorit të programit të studimit përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	DSLAs dhe programet e saj, janë të mbështetura plotësisht në struktura dhe kuadër normativ i brendshëm i plotë. Kështu, kjo njësi bazë mbështetet në statut, strategjinë e IAL-së, rregullore të IAL-së, si dhe rregullore të vetë programit të studimit. Këto dokumenta të rëndësishme të funksionimit ligjor të IAL-s janë plotësisht të mbështetura në ligjin për arsimin e lartë.

	<p><i>Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar te Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.8 Studimi i tregut te punes.pdf</i></p> <p><i>A.1.8 Plani strategjik i zhvillimit të IAL Kolegji Universitar i Biznesit Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i></p> <p><i>A.2.30 Struktura e DSLA.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në planin mësimor të dorëzuar, përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit. Ngarkesa në kredite është e shpërndarë respektivisht në 60 kredite për cdo vik akademik (pra., në total 120 kredite ECTS). Bazuar në dokumentate disponueshme, cdo lëndë/modul ka të përcaktuar ngarkesën në kredite duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p> <p><i>2.28 Planet mësimore për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.2.37 Planet mësimore të programit të studimit "Hoteleri-Turizëm" për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.2.27 Syllabuse të lëndëve të semestrit të parë të vitit akademik 2023-2024 në programin "Hoteleri-Turizëm".pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit trajtohen të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Studentët informohen për këto aspekte që në fazën e të qenurit maturant nëpërmjet ditëve të informimit të maturantëve. Në vazhdim, në statusin e studentit të KUB, studenët informohen në javën e parë të fillimit të viti akademik, si dhe nga stafi akademik i angazhuar.</p> <p><i>Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.17 Rregullore njohjes dhe ekuivalentimit te studimeve ne KUB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën</p>	<p>Syllabuset e lëndëve/moduleve janë në përputhje me Ligjin 80/2015 për arsimin e larë, dhe po ashtu është në përputhje me VKM nr. 41., dt. 24.01.2018, si edhe VKM nr. 879, dt. 18.12.2019. Dokumentat e vena në dispozicion (A.2.28 Planet mësimore për vitin akademik 2023-2024.pdf; A.2.37</p>

<p>lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Planet mësimore të programit të studimit “Hoteleri-Turizëm” për vitin akademik 2023-2024.pdf) është e qartë që Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module.</p> <p><i>Hoteleri Turizëm – Syllabuset e lëndëve. Pdf</i></p> <p><i>A.2.27 Syllabuse të lëndëve të semestrit të parë të vitit akademik 2023-2024 në programin “Hoteleri-Turizëm”.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Në mbledhjet e departamentit diskutohen aspekte të përditësimit të vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit si në aspektin e strukturës së kurrikulës ashtu edhe përmbajtjes së lëndëve/moduleve. Megjithatë, ky është një program studimi i çelur rishtaz dhe nuk mund të gjykohej mbi dinamizimin e këtij aspekti.</p> <p><i>Dok. nr.17 Rregullore njohjes dhe ekuivalentimit të studimeve në KUB.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.7 Rregullore e programit të studimit.pdf</i></p> <p><i>A.2.35 Kopje e procesverbalit mbajtur në mbledhjen me pedagogët e përfshirë në mësimdhënie në semestrin e parë të.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia bazë ku është programi i studimit mbështetet në kuadrin normativ në fuqi (statut, strategjinë e IAL-së, rregullore të IAL-së, si dhe rregullore të vetë programit të studimit) dhe të mbështetura në ligjin për arsimin e lartë. Ky kuadër normativ është i përditësuar në mënyrë të vazhdueshme.</i></p> <p><i>Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>Nga analiza e strukturës së kurrikulës, rezulton se ka paqartësi në përmbajtjen e kurrikules. Kështu, duhet një ri-strukturim dhe pasurim me lëndë që lidhen me profilet e programit. Ka paqartësi dhe ngjashmëri në përmbajtjen e syllabuseve të disa lëndëve (shiko vlerësimin në kriteri 2, Standardi II.1).</p> <p><i>A.2.28 Planet mësimore për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.2.37 Planet mësimore të programit të studimit "Hoteleri-Turizëm" për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.5.101 Kurrikula dhe planet mësimore të programit "Hoteleri-Turizëm" Plani për shpërndarjen e pedagogëve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se tërësia e lëndëve që përbëjnë kurrikulën synon arritjen e objektivave të këtij programi dhe formimin profesional të studentëve sipas rezultateve të pritshme të të nxënit.</p> <p>Në vijim të vlerësimit të kriterit të mësipërm, <i>GVJ gjykon se lënda "Politikat Turisitike" duhet të zhvendoset në vitin e dytë.</i></p> <p><i>A.2.28 Planet mësimore për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.2.37 Planet mësimore të programit të studimit "Hoteleri-Turizëm" për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.5.101 Kurrikula dhe planet mësimore të programit "Hoteleri-Turizëm" Plani për shpërndarjen e pedagogëve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e</p>	<p>Refeuar kuadrit ligjor në fuqi (pra., VKM nr. 41., dt. 24.01.2018, VKM Nr. 879, 18.12.2019), si edhe mbështetur në planin mësimor (A.2.28 Planet mësimore për vitin akademik 2023-2024.pdf) rezulton se 57% e ngarkesës në orë, të dy viteve akademike (pra 3000 orë), është dedikuar seminareve dhe po në të njejtën përqindje edhe për studim individual (si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh, sipas përkufizimi të VKM nr. 41., dt. 24.01.2018, pika 2.2, ii). Në vazhdim, edhe pse janë dedikuar 80 ore praktikë profesionale në semestrin e dytë të vitit të dytë, nuk verifikohet nëse është arriur kufiri prej 25% e programit e</p>

<p>përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>cila duhet ti dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion (sipas VKM Nr. 879, 18.12.2019).</p> <p><i>A.2.28 Planet mësimore për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.2.37 Planet mësimore të programit të studimit "Hoteleri-Turizëm" për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.5.101 Kurrikula dhe planet mësimore të programit "Hoteleri-Turizëm" Plani per shperndarjen e pedagogëve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion si edhe në Nën planin mësimor, u konstatua se në programin e studimit 50.8% të lëndëve të kurrikulës e zënë lëndët karakterizuese për zhvillimin e aftësisë në fushën e menaxhimit të bizneseve të turizmit.</p> <p>Në planin mesimor, janë edhe lëndë ndërdisiplinore, që zënë 13.3% të lëndëve të kurrikulës, si dhe lëndë plotësuese me 17.5 %. Në rregullorën e programit të studimit listohen edhe mundësitë e punësimit të studentëve që diplomohen.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së.</i></p> <p><i>A.2.28 Planet mësimore për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.2.37 Planet mësimore të programit të studimit "Hoteleri-Turizëm" për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.5.101 Kurrikula dhe planet mësimore të programit "Hoteleri-Turizëm" Plani per shperndarjen e pedagogëve.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.17 Rregullore njohjes dhe ekuivalentimit te studimeve ne KUB.pdf</i></p> <p><i>A.5.107 Statuti i KUB, neni 74 Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës Guida studentore.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Në mbledhjet e departamentit diskutohen aspekte të përditësimit të vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit si në aspektin e strukturës së kurrikulës ashtu edhe përmbajtjes së lëndëve/moduleve. Megjithatë, ky është një program studimi i çelur rishtaz dhe nuk mund të gjykohej mbi dinamizimin e kësaj aspekti.</p>

	<p><i>Dok. nr.17 Rregullore njohjes dhe ekuivalentimit te studimeve ne KUB.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i></p> <p><i>A.2.35 Kopje e procesverbalit mbajtur në mbledhjen me pedagogët e përfshirë në mësimdhënie në semestrin e parë të.pdf</i></p> <p><i>A.2.27 Syllabuse të lëndëve të semestrit të parë të vitit akademik 2023-2024 në programin “Hoteleri-Turizëm”..pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Për këtë aspekt ka një procedurë të konsoliduar tashmë. Së pari, KUB edhe për fushën e këtij program studimi ka rreth 182 MoU me kompani, institucione arsimit, institucione publike, dhe NGO që mundësojnë internship-i/përvoja praktike të studentëve të këtij program studimi. Së dyti, IAL ka përcaktuar një listë të stafit (3 saf) që do të jenë tutorë të studentëve gjatë praktikave.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së</i></p> <p><i>A.1.19 Lista e kompanive, institucioneve dhe subjekteve me të cilët DSLA ka marrëveshje për zhvillimin e praktikës profesionale per vitin 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>A.2.39 Lista e miratuar e Drejtorit të KSLP për pedagogët tutorë të praktikës profesionale.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Me reflektime e nevojshme të evidentuara përgjatë kriterëve të mësipërme, gjykohet se përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmërinë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK. Kombinimi i teori-praktikë (50:50), listë me Marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm të tregut të punës, garantojnë këtë aspekt.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së</i></p> <p><i>A.2.37 Planet mësimore të programit të studimit “Hoteleri-Turizëm” për vitin akademik 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.2.27 Syllabuse të lëndëve të semestrit të parë të vitit akademik 2023-2024 në programin “Hoteleri-Turizëm”..pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i></p> <p><i>A.1.19 Lista e kompanive, institucioneve dhe subjekteve me të cilët DSLA ka marrëveshje për zhvillimin e praktikës profesionale per vitin 2022-2023.pdf</i></p>

	<i>A.2.39 Lista e miratuar e Drejtorit të KSLP për pedagogët tutorë të praktikës profesionale.pdf</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, të nivelit 5 të KSHK.</i></p> <p><i>Rezultatet e të nxënit, kompetencat e fituara në përgjithësi janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se Raporti teori / praktikë është 50:50, në përputhje me profilin e programit të studimit si një program jouniversitar 2 vjecar me karakter profesional.</i></p> <p><i>Nga verifikimi I dokumentacionit në dispozicion, nuk arrihet kufiri minimal prej 25% e programit i cili duhet të dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion (sipas VKM Nr. 879, 18.12.2019).</i></p> <p><u><i>Është e nevojshme që në një afat të shkurtër kurrikula të ri-organizohet dhe përmbajtja e disa lëndëve të thellohet, qartësohet dhe shmangen ngjashmëritë.</i></u></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Çelja e këtij program studimi është mbështetur në studim mbi tregun nëpërmjet të cilit janë marrë mendimet (pra janë intervistuar) e aktorëve të interesuar drejtpërdrejt. Megjithatë mungon pjesëmarrja në këtë studim i maturantëve. Kjo do ishte një vlerë e shtuar për studimin duke qene se është një program studimi në ciklin e parë, dhe se maturantet janë ato që synojnë të regjistrohen. Ndër të tjera, në dokumentacionin e ofruar lidhur me studimin, <i>mungon një analizë e të dhënave primare, nuk është e qartë.</i></p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së</i></p> <p><i>Dok. nr.8 Studimi i tregut te punes.pdf</i></p>

	<p><i>A.1.11 Studim i Tregut të Punës” për programin e studimit “Hoteleri-Turizëm”, Mars 2021, i përditësuar në periudhen shtator-tetor 2023.pdf</i></p> <p><i>A.5.109 Kopje e studimit të tregut nga ZSKK.pdf</i></p> <p><i>A.2.41 Faqja e parë e ëebit të Universitetit “Alpine Center”, Zvicër.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentin e ekzaminuar dhe intervista e realizuar pranë institucionit rezulton se studentët janë pjesë e Senatit akademik. Studentët janë mbështetur të formojnë strukturat e tyre për tu përfaqësuar pranë organeve drejtuese të IAL-së. Kështu, ata kanë përfaqësuesin e tyre në SENAT akademik. Megjithatë ka paqartësi se sa është nr i anëtareve student në Senatin Akademik. Studentë konsulohen cdo semestër nëpërmjet pyesorëve lidhur me performancën e stafit akademik.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së</i></p> <p><i>Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar te Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i></p> <p><i>A.2.42 Procesverbal i konsultës organizuar me studentët për përmirësimin e programit “Hoteleri-Turizëm”.pdf</i></p> <p><i>A.1.22 Lista e personaliteteve nga bizneset ne leksione te hapura. Workshope..pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.</p>	<p>Mbështetur në dokumentin e ekzaminuar dhe intervista e realizuar pranë institucioni të IAL-së rezulton se duke konsideruar njw kurrikule e kombinuar nw raport tw mjaftueshme teori-praktikë (50:50), lista me Marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm të tregu të punës, konsultimi i vazhdueshëm me studentët dhe aktorët e tregut, si edhe motivimi i stafit në publikime shkencore dhe pjesëmarrje në projekte, e garanton këtë aspekt.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së</i></p> <p><i>A.2.42 Procesverbal i konsultës organizuar me studentët për përmirësimin e programit “Hoteleri-Turizëm”.pdf</i></p> <p><i>A.1.11 Studim i Tregut të Punës” për programin e studimit “Hoteleri-Turizëm”, Mars 2021, i përditësuar në periudhen shtator-tetor 2023.pdf</i></p> <p><i>A.5.109 Kopje e studimit të tregut nga ZSKK.pdf</i></p>

	<p>A.1.17 Lista e institucioneve kompanive dhe subjekteve me të cilat KUB ka marrëveshje bashkëpunimi..pdf</p> <p>A.2.37 Planet mësimore të programit të studimit "Hoteleri-Turizëm" për vitin akademik 2023-2024.pdf</p>			
Konkluzione	<p>Sa i përket përditësimit në vazhdimësi, ky është një program i çelur rishtazi. Megjithatë, referuar marrëveshjeve me aktorët e tregut, promovimet në shkolla të mesme (pra maturantë), si edhe vëzhgimet e vazhdueshme me studentët, ky program studimi ka potencial për të qenë i përditësuar në vazhdimësi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Mësimdhënia në programin e studimit "Hoteleri-Turizëm" zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, praktika profesionale, orë mësimi në terren, orë të hapura, etj. Forma këto të cilat janë pjesë e syllabuseve për çdo lëndë. Nga vizita në institucion u konstatua se në KUB aplikohen shumë forma të larmishme të leksioneve të hapura të cilat janë në praktikën akademike të institucionit.</p> <p>GVJ pasi konstatoi në dokumentacionin që shoqëron RVB-në, rekomandon që në të ardhmen në praktikën që institucioni bën, në lidhje me leksionet e hapura dhe pasurimin e auditorit me personalitete të spikatur të profilit, të programit studimit të ftohen pikërisht personalitete të shquar të cilët</p>

	<p><i>janë të profilit të Turizmit në përgjithësi dhe Hotelerisë në veçanti.</i></p> <p><i>A.1.22 Lista e personaliteteve nga bizneset në leksione të hapura, ëorkshope</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB_ në dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se natyra e lëndëve të këtij programi studimi, krijon hapsira për përdorimin e formave dhe metodave alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies sikundër janë debatet, diskutimet, vizitat mësimore, prezantimet e studentëve për çështje të caktuara. Këto metoda nxitin mendimin krijues dhe kritik të studentëve. Fomat e mësimit teorik e praktik që zhvillohen në këtë program studimi janë: leksione, seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit, etj. Këto metoda ofrojnë mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> <p><i>A.3.44 Procesverbali i mbledhjes me pedagogët për fillimin e semestrit të dytë të vitit akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB_ në dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se KUB mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. Trajnimet dhe mobilitetet e realizuara janë reflektuar sidomos në dokumentin A.3.45 ku reflektohet raporti mbi aktivitetet e zhvilluara me stafin dhe studentet e KUB si edhe përfaqësues të tjerë të IAL_ve partnere në kuadër të veprimtarisë Erasmus +. Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm dhe aplikimit të formave më të reja të mësimdhënies trajnime të tjera janë realizuar nga Universitetet e Kadizit, Spanjë, Universitetii Shkencave të aplikuara Letoni, etj</p> <p><i>A.3.45 Dokumentat bazë për akreditimin. Raport mbi aktivitetet e zhvilluara me stafin dhe studentët në KUB si dhe me përfaqësuesit e IAL-ve partnere në kuadër të veprimtarisë Erasmus +</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> <p>https://erasmus-plus.ec.europa.eu/programme-guide/part-</p>

	<p>b/key-action-1/key-action-1-learning-mobility-of-individuals</p> <p>https://kub.edu.al/kerkimi-shkencor/</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB_në dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se KUB ka siguruar staf akademik logjistikën të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor duke bërë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Gjatë vizitës në mjediset e institucionit rezultoi se infrastruktura dhe baza materiale në auditore dhe laboratore, në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve, lejon dhe mundëson aplikimin efektiv të metodave të shumëllojshme të mësimdhënies. Sallat e leksioneve seminareve janë të përshtatshme, të pajisura me videoprojektor, tabela për të shkruar, kanë sistem ngrohje, etj. Personeli akademik përdor projektorët për prezantime powerpoint për dhënien e leksioneve dhe prezantimeve.</p> <p><i>GVJ rekomandon që në të ardhmen në praktikën që institucioni ndjek, në përmirësim dhe në rritje më të madhe të kompetencës së shpjegimit të njohurive dhe koncepteve të këtij profili duke angazhuar personel akademik më afër këtij profili. Me staf akademik të background_it të programit të studimit "Hoteleri-Turizëm".</i></p> <p><i>A.3.47 Lista me stafin që mbulon programin e studimit</i> <i>Dokumentat shtesë (CV STAFI Hoteleri Turizëm total. pdf)</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB_në dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se DSLA vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. Këto mendime vijnë kryesisht gjatë anketimeve që zhvillon njësia e brendëshme e sigurimit të cilësisë dhe nga vetë departamenti. Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetësori i studentëve, të cilat analizohen edhe në analizën vjetore të departamentit.</p>

	<i>A.3.48 Relacion nga vëzhgim i një ore leksion në lëndën Politika turistike</i> <i>Vizita në institucion</i>			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	GVJ si nga dokumentacioni që shoqëron RVB_në por edhe nga vizitat në institucion konstatoi se të tërë strukturat përgjegjëse në KUB analizojnë periodikisht dhe promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies duke koordinuar dhe bashkërenduar veprimtaritë e tyre në funksion të përmirësimit të cilësisë. Për këtë qëllim institucioni organizon konferenca shkencore, seminare kualifikuese me stafin apo bën gjithashtu promovimin e elementëve të stafit akademik. <i>Vizita në institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KUB nëpërmjet departamentit përgjegjës për këtë program studimi, garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Institucioni në përmbushje të akteve ligjore dhe nënligjore ka ngritur strukturat përkatëse që promovojnë vlerësojnë dhe mbikëqyrin përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB_në dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se KUB nënrmjet rregullorese se tij si institucion përcakton qartë mënyrat e testimit dhe të vlerësimit të njohurive. Kriteret e vlerësimit të cituara janë të pasqyruara si akte detyruese në të gjitha nenet e rregulloreve që garantojnë të gjithë procesin e arsimimit , nga regjistrimi deri në provimet përfundimtare përmbyllëse dhe diplomimi. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale per kete program studimi behen publike dhe njihen nga studentët.</p> <p><i>A.3.48 Relacion nga vëzhgim i një ore leksion në lëndën Politika Turistike</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB_në dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se në fillim të çdo moduli të programit të studimeve të programit të studimit lektori ju bën me dije studentëve programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe literaturën, që do të përdoret në modulën përkatës. Studentëve që në orët e para të leksioneve ju bëhet me dije struktura e lëndës më përqindjet në vlerësimet, ku dallojnë dy zëra kryesorë: ai i vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimi përfundimtar me provimin përmbyllës.</p> <p><i>GVJ rekomandon që në të ardhmen përmbajtja e syllabuseve të lëndëve të pasurohet me literaturë bazë të përditësuar të viteve të fundit. Gjithashtu të evitohen e shmangen mbivendosje temash nga lëndë të tjera. Rasti i Temave të përsëritura të librit Ekonomia e Turizmit në përmbajtje të syllabusit politika Turistike.</i></p> <p><i>A.2.27 Syllabuset të lëndëve të semestrit të parë të vitit akademik 2023-2024 në programin "Hoteleri-Turizëm". Model "Politika Turistike</i></p> <p><i>Hoteleri Turizëm – Syllabuset e lëndëve. Pdf</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik dhe studentet e programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale</p>	<p>GVJ si nga dokumentacioni që shoqëron RVB_në por edhe nga vizitat në institucion konstatoi se në këtë program studimi, provimi është forma kryesore e kontrollit për</p>

realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.	<p>vlerësimin e nivelit të dijeve, që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lende te caktuar. Gjithashtu aplikohen edhe format e ndryshme si debate, diskutimi, ballafaqimi, detyrat e pavarura, esetë, prezantimi i kazueseve, ushtrimet e problemat në orën e seminareve.</p> <p><i>Dok. nr.7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>A.3.51. Formulari i vlerësimit të vazhduar dhe përfundimtar</i> <i>Takim me stafin akademik dhe studentet e programit.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se KUB ka të plotë kuadrin rregullator, mbikëqyrës dhe procedural të vlerësimit të dije të studenteve gjatë procesit mësimor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ si nga dokumenteacioni që shoqëron RVB_në por edhe nga vizitat në institucion konstatoi se vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat tashme të njohura të përdorura në IAL në Shqipëri. Njohuritë e marra gjatë procesit të zhvillimit të këtyre lëndëve vlerësohen me nga 10% deri në 40 % (angazhim në seminar, provimi i ndërmjetëm dhe detyra e kursit), ndërsa provimi përfundimtar zë deri 60% të vlerësimit.</p> <p><i>Dok. nr.7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>A.3.51. Formulari i vlerësimit të vazhduar dhe përfundimtar</i> <i>Takim me stafin akademik dhe studentet e programit.</i> <i>A.3.52. Kopje vlerësimi të vazhduar për studentët profili "Hoteleri" në lëndën "Ekonomi Turizmi"</i> <i>Hoteleri Turizëm – Syllabuset e lendeve. Pdf</i> <i>Takim me stafin akademik dhe studentet e programit.</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB_në dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se vlerësimi bëhet direkt nga pedagogu i lëndës por ekziston edhe praktika e komunikimit elektronik i rezultatit por jo i sistemit të testimit elektronik.</p> <p>Nga viti akademik 2023-2024 KUB është në proces implementimi të “Sistemit Pitagora”, nje instrument i cili do të rrisë më shumë jo vetëm transparencën por edhe do të lehtësojë ndjeshëm komunikimin midis Pedagogëve, sekretarisë si edhe studentit.</p> <p><i>A. 3.53. Rregullore për Procedurat e Zhvillimit të Provimeve, nenet kreu III, nenet 6,7,8,9,10</i></p> <p><i>Hoteleri Turizëm – Syllabuset e lendeve. Pdf</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik dhe studentet e programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e procedurave të zhvillimit të provimeve, e në rregulloren e këtij program dhe programet e lëndëve, GVJ evidentoj praktikë vlerësimi të studenteve ku konfirmohet se vlerësimi përfundimtar reflekton zbatimin e këtyre akteve rregullative. Vlerësimi përfundimtar i bazuar në pikë reflektohet në notën përkatëse që është i detyrueshëm.</p> <p><i>A. 3.53. Rregullore për Procedurat e Zhvillimit të Provimeve, nenet kreu III, nenet 6,7,8,9,10</i></p> <p><i>Hoteleri Turizëm – Syllabuset e lëndëve. Pdf</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik dhe studentët e programit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni konstatoi se vlerësimi përfundimtar i lëndës është një shumatore e vlerësimit të vazhduar deri në ”40 pikë” dhe i vlerësimit në provimin përfundimtar të lëndës “60 pikë” të përshkuara në syllabuset e lëndëve, duke qënë në përputhshmëri me kërkesat e VKM_së nr. 41, dt. 24. 01. 2018.</p> <p><i>Hoteleri Turizëm – Syllabuset e lëndëve. Pdf</i></p> <p><i>A. 3. 54. Formulari i Vlerësimit të vazhduar dhe kopje e proceverbalit të provimit përfundimtar të lëndës</i></p> <p><i>A. 3.53. Rregullore për Procedurat e Zhvillimit të Provimeve, nenet kreu III, nenet 6,7,8,9,10</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>

<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator në nivel institucional dhe të njësisë bazë, DSLA në bashkëpunim me strukturat në nivel institucional (NJSBC) monitoron zhvillimin normal të testimit duke u përpjekur që ai të jetë realist dhe vlerësimi të jetë meritë e angazhimit të studentëve me njohuritë e kërkuara duke eliminuar sa më shumë format e kopjimit apo të abuzimit në këtë drejtim në rregulloren përkatëse evidentohen edhe mjaft detaje në funksion të realizimit të provimit sa me serioz.. Nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion, na u konkludua se në këtë program studimi, personeli akademik dhe përgjegjësi i departamentit janë munduar të jenë sa më korrekt që të jetë e mundur.</p> <p><i>Takim me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Realizimi me korrektësi i testeve gjatë vitit akademik dhe në fund të tij është një garanci për vlerësimin e saktë të studentëve. Referuar edhe syllabuseve të moduleve këto kontrole u referohen frekuentimit të lëndës, aktivizimit, testeve të ndërmjetme si edhe provimit Perfundimtar. Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB_në dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi gjithashtu se vlerësimi mbi aftësitë e studentit është gjithëvjetor dhe me tregues të veçantë në mënyrë specifike. Këto vlerësime janë tregues të matshëm të peshës specifike që zënë në formimin e përgjithshëm profesional të studentit dhe për rrjedhojë edhe të certifikimit të aftësive të tij.</p> <p><i>Hoteleri Turizëm – Syllabuset e lëndëve. Pdf</i> <i>A. 3. 56 Rregullore për Procedurat e Zhvillimit të Provimeve, nen16</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoj se rregullorja e KUB për vlerësimin dhe ankimin e studentëve është si më poshtë. Pas shpalljes së rezultateve dhe hedhjes së tyre në sistem, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi, ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda tre ditëve (72 orë). Pedagogu i lëndës së provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë pas rishikimit të provimit, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare duke u bërë mbyllja përfundimtare e</p>

	procesverbalit në sistem.			
	<i>A. 3. 57. Rregullore e KUB, nen 97.</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB në dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se në <i>nenin 16</i> të rregullores për procedurat e provimeve është parashikuar e gjithë procedura përkatëse. Edhe në rastet kur studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin, depoziton një kërkesë në bazë të së cilës departamenti shprehet ose vendos rimarrjen në provim me komision studentin ankimues.			
	<i>A. 3. 56 Rregullore për Procedurat e Zhvillimit të Provimeve, nen16</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studenteve duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimimit nga studentet dhe zgjidhjes se saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve në profilin e turizmit. Lëndët që bëjnë pjesë në kurrikulën e programit të studimit të këtij programi përfshijnë njohuri, që japin formimin e përgjithshëm bazë, të cilat gradualisht në vitet pasardhëse thellohen, në njohuri në fushën e hotelierisë, me njohuri aplikimi në bizneset e turizmit etj. Kjo kurrikul i drejton studentët e këtij programi studimi, që t'i thellojnë më tej njohuritë e tyre në të dy drejtimet, si menaxhimin të bizneseve turistike në përgjithësi ashtu edhe të bizneseve hoteliere në veçanti.

	<p><i>Hoteleri Turizëm – Syllabuset e lëndëve. Pdf</i></p> <p><i>5. Aneke tabela përmbledhëse të RVB “Kurrikula_Plani mësimor”.pdf</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB në dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se në programin e studimit 50.8% të lëndëve të kurrikulës e zënë lëndët karakterizuese për zhvillimin e aftësisë në fushën e menaxhimit të bizneseve të turizmit rural, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • "Sjellje Konsumatore"; • "Hoteleri"; • "Ekonomi Turizmi"; • "Shërbime Hoteliere dhe Turistike"; • "Mardhenie me Klientin dhe shërbimin"; • "Guida Turistike"; • "Destinacione Turistike"; • "Ndermarrje Hoteliere"; • "Menaxhim Eventesh"; • "Menaxhim në Hoteleri"; <p>Në planin mesimor, janë edhe lëndë ndërdisiplinore, që zënë 13.3% të lëndëve të kurrikulës, si dhe lëndë plotësuese me 17.5 %.</p> <p><i>Hoteleri Turizëm – Syllabuset e lëndëve. Pdf</i></p> <p><i>5. 5. Aneke tabela përmbledhëse të RVB “Kurrikula_Plani mësimor_kategorizimi i lëndëve”.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB në dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se programi i studimit ën vlerësim përdor si format, syllabuset sipas VKM-së Nr 41, viti 2018, e ndryshuar. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të vitit shkollor (në syllabus është rubrika përmbledhje dhe rezultatet e të nxënurit).</p> <p><i>1. 21 Analiza e punës së DSLA për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023</i></p>

	<i>Takim me stafin akademik dhe studentët e programit</i>			
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>GVJ konstatoj se DSLA në përputhje me kriteret akademike për arsimin e lartë profesional, në këtë program studimi ka ruajtur raportin e orëve të planifikuara praktikë 50 % me 50% pjesën teorike. Ndërkohë departamenti në vijim të mësimdhënies tradicionale zhvillon trajnime e mësim të hapura midis pedagogëve të rinj si edhe atyre me tituj akademik e me përvojë në mësimdhënie.</p> <p><i>A.3. 61. Prezantimi i realizuar me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie në programet e DSLA "Mbi metodat aktive të mësimdhënies"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB në dhe në vizitën në institucion GVJ, konstatoi se institucioni zhvillon leksione të hapura me personalitete të ftuara të fushës. Pikërisht në funksion të këtij elementi edhe duke u bazuar nga dokumentat e vëna në dispozicion.</p> <p><i>GVJ rekomandon që në të ardhmen në praktikën që institucioni bën, në lidhje me leksionet e hapura dhe pasurimin e auditorit me personalitete të spikatur të profilit, të programit studimit "Hoteleri-Turizëm", të ftohen pikërisht personalitete të shquara të cilët janë të profilit të Turizmit në përgjithësi dhe Hotelerisë në veçanti.</i></p> <p><i>A.1.22 Lista e personaliteteve nga bizneset në leksione të hapura, ëorkshope</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se programi i studimit dy vjeçar, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB_në dhe në vizitën në institucion GVJ, konstatoi se procedura e përfundimit të studimeve në KUB është e mire përcaktuar në kurrikulën e programit mësimor, strukturën akademike, në udhëzimet përkatëse që rrjedhin në kuadrin e realizimit të procesit mësimor, me të cilat student njihet që ditën e parë, ashtu sikundër për të gjitha këto ka edhe rregullore të përgjithshme, të veçanta, por për detyrime përmbyllëse ka edhe një udhëzim të veçantë i cili u bëhet me dije studentëve, për kohën e përgatitjes, konsultimeve dhe provimeve.</p> <p><i>A. 3. 62. Udhëzim i drejtuesit të njësisë kryesore "Per Procedurat e Zhvillimit të Provimit të Diplomimit në Programin e Studimeve të larta Profesionale në KSLP"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se personeli akademik në këtë program studimi është në dispozicion të studenteve lidhur me detyrimet përmbyllëse dhe jo vetëm. Ata ju vënë në dispozicion materialet e nevojshme të kërkuara prej tyre, si dhe ju vendoset në dispozicion një listë me raste studimore dhe pyetje ose ushtrime nga lëndët e profilit. Gjithashtu ju rekomandohen dhe materialet të cilat gjenden në bibliotekën e universitetit, por dhe të fakultet. Në të njëjtën kohë personeli akademik organizon edhe konsultime, nëse studentët e ndiejnë të nevojshme.</p> <p><i>A. 3. 63. Udhëzim i drejtuesit të njësisë kryesore "Për Procedurat e Zhvillimit të Provimit të Diplomimit në Programin e Studimeve të larta Profesionale në KSLP, pika 4, fq. 2"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB_në dhe në vizitën në institucion GVJ, konstatoi se për provimin e diplomimit, DSLA është përgjegjës të ndjekë rezultatet e provimit duke pasur përgjegjësi direkte të njohjes dhe</p>

<p>njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>zbatimit në praktikë të rregullave dhe procedurave të provimit duke u bazuar në rregulloren për testimet e provimit, kriteret dhe proceduratë diplomimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>A. 3. 64. Urdhër i Drejtorisë së KSLP-së "Mbi ngritjen e Komisionit të provimit të formimit të studentëve"</i></p> <p><i>Dok. Nr. 10 Rregulloren për testimet e provimit, kriteret dhe proceduratë diplomimit.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB në dhe në vizitën në institucion GVJ, konstatoi se provimi i diplomimit në programin e studimit nuk realizohet me mbrojtje diplome por me provim formimi. Për këtë qëllim hartohet seti i pyetjeve për këtë provim bazuar në pyetjet e dërguara nga ana e pedagogëve të lëndëve përkatës dhe që përfshijnë esencën e lëndës. Pasi ky set pyetjesh miratohet në departament dhe në Drejtorinë e KSLP u dërgohet studentëve një muaj para zhvillimit të provimit të provimit të formimit.</p> <p><i>A. 3. 64. Urdhër i Drejtorisë së KSLP-së "Mbi ngritjen e Komisionit të provimit të formimit të studentëve"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>	<p>N / A</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët e këtij programi në përfundim të studimeve, nuk mbrojnë temë diplome, por japin provim formimi. Ngrihet një komision akademik nga departamenti, i cili testojnë dijet e fituara gjatë dy viteve të studimit dhe bëjnë vlerësimin me notë. Nota përfundimtare që hidhet në procesverbalin e provimit është rezultat i</p>

	<p>konsensusit të komisionit ose i mesatares së anëtarëve të komisionit.</p> <p><i>A. 3. 65. Kopje e procesverbalit të provimit të diplomimit” Vizita në institucion me stafin e DSLA</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të institucionit, diplomimi bëhet me provim formimi. Tezat e provimit të formimit hartohen nga departamenti në bashkëpunim me pedagogët e lendeve. Provimet e formimit vlerësohen nga i njëjti komision vlerësimi. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e thjeshtë e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit dhe i bëhet e ditur studentit ditën e dhënies së provimit, në përfundim të ditës së provimit. Studenti i programit të studimit pajiset me “Diplom Profesionale”. Diploma shoqërohet me suplementin përkatës, e sipas kërkesës së tij pajiset me një kopje të programit të studimit në çdo kohë që ai kërkon.</p> <p><i>A. 3. 66. Kopje e diplomës “Hoteleri – Turizëm” në profilet “Hoteleri” dhe “Agjenci Udhëtimesh” së bashku me suplementin përkatës. Vizita në institucion me stafin e DSLA</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Dokumentacioni për studentët ruhet nga IAL-KUB për një periudhë të pacaktuar në hard kopje, si dhe në databazën digitale, që tashmë disponon KUB. Dokumentacioni ruhet në ambientete e KUB-it. Diplomat e studimit të programit dyvjeçar “Hoteleri-Turizëm” pajiset me “Diploma Profesionale” regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çefifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Qendren e Sherbimeve Arsimore (QSHA).</p> <p>Regjistrimi i diplomave bëhet në regjistrin shtetëror të diplomave që njësia kryesore ka.</p> <p><i>A. 3. 67. Procedurat në sekretarinë mësimore dhe arkiva e KUB</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se KUB ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</i></p> <p><i>Në rregullore, urdhëra etj janë të përcaktuara të gjitha hapat për provimin përfundimtar, që nga lëndët që përfshihen,</i></p>

	<p>hartimi i tezave, korigjimi i provimeve, procedura e ankimimit etj.</p> <p>Në përfundim të studimeve studenti pajisjet me Diplomë Profesionale dhe me Suplementin e Diplomës dhe një kopje e plote zyrtare e programit të zhvillimit i vihet në dispozicion.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB në dhe në vizitën në institucion GVJ, konstatoi se KUB ka në praktikën e tij ngritjen e infrastrukturës me pajisjet përkatëse shoqëruar me dhënien e udhëzimeve të veçanta në funksion të rrethanave të diktuar. I tërë mjedisi mësimor është i paisur me videoprojektor, laptop dhe kondicionerë, në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>A. 3. 68. Udhëzues për përdorimin e Portalit të KUB nga ana e pedagogëve.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ, konstatoi se departamenti DSLA i cili administron këtë program studimi, monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik nga ana e institucionit realizohet në mënyrë periodike si nga strukturat e rektoratit ashtu dhe nga ana e vetë departamentit. Gjithashtu, element tjetër që përdoret nga departamenti, është dokumenti i performancës, ku stafi akademik dokumenton ngarkesën mësimore etj.</p> <p><i>A. 3. 69. Relacioni nga vëzhgimi i një ore mësimi në lëndën "Politika Turistike".</i></p>

	<i>Vizita në institucion</i>			
Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Institucioni në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies ka dy struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, e cila është NJSBC njesia e brendshme e sigurimit të cilësisë në nivle njësie kryesore. Misioni i të cilës përveç funksioneve të tjera është kordinimi dhe monitorimi i gjithë procesit mësimor, plus dhe bërja publike e rezultateve të vlerësimit.</p> <p><i>A. 3. 70. Raporti I NJSBC për semestrin e parë viti akademik 2022-2023, fq.8”.</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB në dhe në vizitën në institucion GVJ, konstatoi se KUB, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Rastet e specifikuar si pozitive promovohen në strukturat e ndryshme të KUB. Institucioni është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies ashtu dhe për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Këtë rol në KUB e kryen ZSKK, NJSBC, ZBNJAA, zyra e studimeve dhe studentëve, departamenti etj.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se KUB ndjek një politikë që promovon cilësinë në mësimdhënie.</i></p> <p><i>Institucioni ka hartuar udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave mësimdhënëse. Gjithashtu nëpërmjet një sërë rregulloresh dhe procedurash bën monitorimin e saj.</i></p> <p><i>KUB përmes NJSBC monitoron personelin akademik në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
----------	-----------

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton që personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi në lidhje me nivele të kualifikimit.

Në dosje janë paraqitur të dhëna për stafin mësimdhënës për programin e studimit për dy vite akademike, por u konstatua mospërputhje e të dhënave të stafit mësimdhënës midis tabelave 6, 7 dhe 12, GVJ iu referua tab 12 me të dhënat si më poshtë:

Titujt grada	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-
Prof.As.	1	-	-	-
Dr/Phd.	2	1	5	1
Msc.	4	1	5	-
Totali	7	2	10	1

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, kërkuar gjatë vizitës në institucion për vitin e fundit akademike. Respektivisht në vitin akademik 2023-2024 orët e realizuar nga staf PAE rezultojnë të jetë 98.5% .

Nga shqyrtimi i CV_ve të stafit akademik, vizita në institucion por edhe nga diskutimi me stafin efektiv PAE, GVJ konstaton se background-et, fushat akademike-kërkimore të përgjithshme dhe specifike të anëtarëve të personelit akademik PAE që mbulojnë këtë program studimi nuk janë dominantë e në përputhshmëri të plotë me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve e lëndëve të tyre.

	<p><i>GVJ rekomandon drejtuesit e KUB, të rekrutojnë stafit akademik efektiv me background dhe fushat akademike-kërkimore në Turizëm dhe Hoteleri, si dhe drejtimin e tyre në studimet në nivel Doktorature apo edhe post Doktorature ta kenë po në drejtim të profilit "Hoteleri-Turizëm".</i></p> <p><i>Vizita në Institucion me stafin akademik PAE</i></p> <p><i>Kurrikula e programit të studimit</i></p> <p><i>CV të stafit Hoteleri Turizëm total.pdf</i></p> <p><i>Procedura rekrutimi stafi akademik</i></p> <p><i>Anekse tabelat përmbledhëse të RVB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton se për dy vitet e fundit akademike, stafi akademik efektik e mbulon ngarkesën mësimore, në auditor me mbi 70 % konkretisht:</p> <p>Viti 2022-2023 83 % mbuluar nga PAE;</p> <p>Viti 2023-2023 98.5% mbuluar nga PAE;</p> <p><i>Anekse tabelat përmbledhëse të RVB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>KUB dëshmon nëpërmjet dokumentacionit shoqërues për qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Për periudhën 2023-2024 janë bërë vetëm 3 lëvizje stafi akademik 2022-2023. I gjithë stafi akademik efektiv ka nënshkruar kontrata punësimi me institucionin dhe është i mbuluar me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><i>4. 72 Kontratë Pune tip për stafin Akademik me kohë të plotë</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe</p>	<p>GVJ nga RVB dhe dokumentacioni mbështetës paraqet qartë procedurën e rekrutimit të stafit me kohë të plotë. Njësia bazë bazohet në rregulloren për punësim të KUB, e cila paraqet qartë kriteret. Rregullorja përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit që drejton konkursin për vendin e lirë të punës.</p> <p><i>Vizita në Institucion me stafin akademik PAE</i></p>

<p>përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p><i>Kurrikula e programit të studimit</i> <i>CV të stafit Hoteleri Turizëm total.pdf</i> <i>Procedura rekrutimi stafi akademik</i> <i>Anekse tabelat përmbledhëse të RVB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Nga të dhënat tabelore rezulton se DSLA ka 1 (një) punonjës si personel ndihmës akademik.</p> <p><i>5. Anekse tabela përmbledhese te RVB;</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p>	<p>GVJ konstatoi që DSLA ka staf ndihmës për departamentin duke përfshirë dhe asistenten e angazhuar në punët administrative. Gjithashtu pjesë e stafit ndihmës për realizimin e orëve laboratorike të cilët asistojnë në ambientet e laboratorëve, të cilët përdoren nga stafi akademik sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p><i>Anekse tabelat përmbledhëse të RVB.pdf</i> <i>Vizita në Institucion me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe</p>	<p>GVJ konstatoi se KUB në nivel institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera, institucione dhe organizata biznesi të cilat ndihmojnë dhe ofrojnë studentëve të programit të studimit praktika profesionale.</p> <p>Për realizimin me sukses të praktikës profesionale, aspektet rregulluese janë përcaktuar në Rregulloren e zhvillimit të praktikës profesionale. Kjo rregullore ka përcaktime të detajuara lidhur me procedurat e zhvillimit të praktikës si dhe përgjegjësitë dhe rolin e subjekteve të përfshira në këtë proces. Përgjegjësi i departamentit përcakton pedagogët</p>

<p>mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>përgjegjës për zhvillimin e lëndës ë praktikës në të gjitha profilet. Në këtë mënyrë, mundësohet plotësimi i detyrimeve që studentët kanë në raport me zhvillimin e praktikës deri në vlerësimin përfundimtar. Praktika profesionale zhvillohet në vitin e dytë të programit dhe ka një kohëzgjatje prej pesë javësh. Në përfundim të praktikës profesionale studenti vlerësohet me notë. Institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh me institucione, studio dhe kompani me anë të të cilave mundësohet zhvillimi i praktikës profesionale në këtë program studimit në të tre profilet e programit. Përcaktimi i institucionit/kompanisë ku studenti do të zhvillojë praktikën mundësohet nga KUB, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura për këtë qëllim.</p> <p><i>A.1.20 Paketa e Praktikës Profesionale</i></p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit A. 1. 15.- A. 1. 16.- A. 1. 17.- A. 1. 18.- A. 1. 19.- A. 1. 20.</i></p> <p><i>Vizita në Institucion me Studentët dhe Stafin</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në pëmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Bazuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në funksion të praktikave profesionale të studentëve të programit, realizohen vizita në ambientet e praktikave dhe takime me studentët për ti orientuar në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës. Stafit supervisor i praktikave është gjithashtu pjesë në procesin e vlerësimit të tyre në fund. Në kuadër të marrëveshjeve, por edhe me vullnetin e tyre të mirë për tu shërbyer studentëve në pëmbushjen e detyrimeve të tyre, drejtuesit e bizneseve në formë të organizuar apo veç e veç kanë udhëzime me vlerë për studentët në praktikën profesionale.</p> <p><i>A. 4. 76. Model vlerësimi i raportit të praktikës</i></p> <p><i>Vizita në Institucion me Studentët dhe Stafin</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, pëmbush standardet sasiore, por nuk ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon drejtuesit e KUB, të rekrutojnë stafit akademik efektiv me background dhe fushat akademike-kërkimore në Turizëm dhe Hoteleri, si dhe drejtimin e tyre në</i></p>

	<p><i>studimet në nivel Doktirature apo edhe post Doktorature ta kenë po në drejtim të profilit "Hoteleri-Turizëm".</i></p> <p><i>Rekrutimi i stafit akademik, ndihmës-akademik, personelit administrativ në KUB bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>DSL A zhvillon procesin mësimorë në godinën qendrore të KUB. Bazuar në dokumentacionin e ofruar, RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi që mjediset në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimorë për programi e studimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme.</p> <p>GVJ konstatoi se KUB ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><i>4.77, Infrastruktura dhe mjediset e KUB/Relacion mbi infrastrukturën dhe ambientet pritëse në KUB</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat</i></p> <p><i>Planimetria e Godinës</i></p> <p><i>Mjediset e KUB</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës se sallat që përdoren gjatë procesit mësimorë janë të pajisura dhe të përshtatshme për përdorim të projektorëve të cilët janë të lëvizshëm dhe thjeshtë të montueshëm nga stafi akademik. Sallat e leksionit dhe laboratorit janë të pajisura me video projektorë, tabela bashkëkohore, kompjuterë dhe vende pune me internet. Në</p>

<p>informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>godinën e përdorur nga DSLA ofrohen dhe zyrat e stafit janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për procesin mësimorë.</p> <p>Godina ku ushtrohet aktiviteti mësimdhënës është e paisur edhe me sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, shkallët e emergjencës si dhe sistemin e fonisë që ndihmon në realizimin me sukses të aktiviteteve shkencore. Gjithashtu edhe laboratorët janë të paisur me të gjitha programet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor në programet profesionale sipas profileve.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Mjediset e KUB</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p><i>A. 4. 78 Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit</i></p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ konstatoi se KUB, ofron dy laboratorë informatike, një me 24 komplete kompjuterash (PC), dhe tjetri me 50 PC të cilët janë të lidhur në rrjet dhe ne internet non stop. Gjithashtu KUB ka ngritur edhe 2 laboratorë të: Laboratori i Mekanikës dhe ai i Elektrik, Elektronikës</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Mjediset e KUB</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p><i>A. 4. 79 Mjedisi fizik i laboratorëve në godinë</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se KUB ka vënë në dispozicion të programit të studimit mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për formimin praktik. Mjediset infrastrukturore plotësojnë normativat ligjore.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se KUB ka vënë në dispozicion të programit të studimit mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për formimin praktik. Mjediset infrastrukturore plotësojnë normativat ligjore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi që pedagogët e lëndëve paraqesin çdo fillim semestri të studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit e cila mundësohet nga vetë ato dhe biblioteka. Në bibliotekën e KUB ku disponon një mjedis të bollshëm si në sipërfaqe/metra katror por edhe në disponueshmëri kompjuterike, gjendet një numër i rëndësishëm tekstesh mësimore në total në dispozicion te DSLA_së.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Titujt e librave në bibliotekë</i> <i>Procedurë e pasurimit të bibliotekës</i> <i>Hoteleri Turizëm – Syllabuset e lëndëve. Pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi çdo fillim semestri stafi akademik bën përditësimin e literaturës në përdorim të çdo lënde në mënyrë që të garantohet marrja e njohurive të nevojshme por megjithatë vërehen nevoja e pasurimit me literaturë të përditësuar, ku në syllabuset e lëndëve kryesore të kurrikulës së programit literatura bazë rezulton të jetë shpeshherë më e vjetër se e 10 viteve të fundit.</p> <p><i>GVJ rekomandon një përditësim më dinamik të literaturës së viteve të fundit dhe sa më bashkëkohore.</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Titujt e librave në bibliotekë</i> <i>Procedurë e pasurimit të bibliotekës</i> <i>Hoteleri Turizëm – Syllabuset e lëndëve. Pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që KUB vë në dispozicion të studentëve dhe stafit të bibliotekën e universitetit e cila mundëson një fond tekstesh kompleks gjithashtu edhe në funksion të programit i cili është në proces akreditimi.</p>

<p>apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Titujt e librave në bibliotekë</i></p> <p><i>Hapësira për student në ambientin e bibliotekës</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p><i>Hoteleri Turizëm – Syllabuset e lendeve. Pdf</i></p> <p><i>A.4.82. Fondi për blerjen e librave, Relacioni financiar KUB 21-22 për bibliotekën fq. 5/Kërkesa e DSLA për blerje librash për dy programet e studimit që mbulon</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB në dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se KUB vë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën e cila mundëson 7000 libra ekzemplarësh të shfrytëzueshme për aktivitet kërkimorë dhe veprimtari promovuese.</p> <p>Studentët e KUB_së kanë akses dhe në biblioteka elektronike të huja ku institucioni ka bërë abonim një vjeçar ose stafi dhe studentët mund të kenë akses falas, këto janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. https://www.questia.com/ 2. https://sr.ithaka.org/publications/ 3. https://www.academia.edu/ 4. https://www.gutenberg.org/ 5. https://al.cobiss.net/ 6. https://www.thefreelibrary.com/ 7. https://www.ebrary.com/corp/ 8. https://www.blib.si/?&language=eng 9. https://anatolia.libguides.com/bissell-online-library/hospitality-tourism#s-lg-box15157103 10. https://z-lib.is/categories/hospitality-management 11. https://uq.pressbooks.pub/hospitalityeducation/front-matter/title-range/ <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Titujt e librave në bibliotekë</i></p> <p><i>Hapësira për student në ambientin e bibliotekës</i></p>

	<p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p><i>A.4.82. Fondi për blerjen e librave, Relacioni financiar KUB 21-22 për bibliotekën fq. 5/Kërkesa e DSLA për blerje librash për dy programet e studimit që mbulon</i></p> <p><i>A. 4. 83 Fatura e pagesës nga ITHAKA; JSTOR; PORTICO. Lista e linqeve për studentët e hoteleri-turizëm. pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se KUB ka krijuar mundësi dhe ofron për studentët por edhe për stafin, fond tekstesh edhe për drejtimin e turizmit dhe hotelerisë.</p> <p>Biblioteka mund të shfrytëzohet njëloj nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike të cilat u vihen në dispozicion dhe u vijnë në ndihmë studentëve.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Titujt e librave në bibliotekë</i></p> <p><i>Hapësira për student në ambientin e bibliotekës</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p><i>Hotelieri Turizëm – Syllabuset e lendeve. Pdf</i></p> <p><i>A.4.82. Fondi për blerjen e librave, Relacioni financiar KUB 21-22 për bibliotekën fq. 5/Kërkesa e DSLA për blerje librash për dy programet e studimit që mbulon</i></p> <p><i>A. 4. 83 Fatura e pagesës nga ITHAKA; JSTOR; PORTICO. Lista e linqeve për studentët e hoteleri-turizëm. pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programit se biblioteka siguron akses pa pagesë në burimet ndërkombëtare elektronike. Ndersa fizikisht ajo është e hapur në orar të përshtatshëm sa i takon orareve të zhvillimit të procesit mesimor duke u aksesuar nga stafi akademik por edhe studentët.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Titujt e librave në bibliotekë</i></p> <p><i>Hapësira për student në ambientin e bibliotekës</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p><i>https://kub.edu.al/libraria/</i></p>

<p>Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>Bazuar në RVB, dhe në dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që DSLA, përgjegjëse për programin e studimit, në periudha të vazhdueshme evidenton nevojat e fondit fizik të bibliotekës dhe ndjek procesin e përditësimit të këtij fondi. Gjithashtu ajo ndjek afatet e vlefshmërisë së kontratave për ato biblioteka online për të cilat KUB paguan tarifën përkatëse.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Titujt e librave në bibliotekë</i> <i>Procedurë e pasurimit të bibliotekës</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, vizita me stafin dhe studentët e programi, GVJ konstaton se literatura bazë dhe ndihmëse e programit të studimit, u mundëson studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program. Por GVJ rekomandon një përditësim të literaturës më dinamike, njëkohësisht sikurse është rekomanduar edhe në kriterin 2 Standardi III. 2, të evitohen e shmangen mbivendosjet e temave nga lëndë të tjera me literatura të njëjta në lëndë të ndryshme. Rasti i Temave të përsëritura të librit Ekonomia e Turizmit në përmbajtje të syllabusit Politika Turistike. Pra të sigurohet literature specifike sipas lëndëve</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion së Sekretaria e KUB_it është përgjegjëse si edhe realizon sistemin e menaxhimit të informacionit që lidhet me studentët nga regjistrimi deri në diplomim.</p> <p>Gjatë takimit në sekretarinë e programit u bë e mundur shqyrtimi i regjistrave të studentëve dhe dy dosje të zgjedhura të studentëve në programin e studimit, të cilat rezultuan me informacion të plotë të nevojshëm sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi PITAGORA, i cili ishte në proces implementimi, do të shërbejë si një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre.</p> <p><i>Platforma Pitagora</i> <i>Vizita në Institucion</i> <i>A. 4.85, Dosja e studentit (në sekretarinë mësimore)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik dhe ndihmës akademik dhe partnerët e angazhuar në programin e studimit, menaxhohet dhe arkivohet nga struktura e Burimeve Njerëzore. Informacionet lidhur me partnerët e angazhuar në realizimin e programit ruhen në DSLA dhe në zyrat përkatëse si: Zyra e Koordinimit dhe Mbeshtetjes për Studentët, Zyra e Marrdhënieve me Jashtë, Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike etj.</p> <p>Në websit-in e KUB, në të gjitha rubrikat e tij ka informacion dhe dokumenta mbi aktivitetin e personelit akademik, ndihmes akademik dhe atij administrativ.</p> <p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma PITAGORA, është në proces implementimi, garanton akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit dhe me funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë KUB: si programet mësimore sipas cikleve të studimit, grafiku i provimeve, rezultatet deri në diplomim etj.</p> <p><i>Platforma Pitagora</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Platforma PITAGORA, prej një viti është në proces implementimi, sistemi që mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna për stafin dhe studentët e KUB, por GVJ konstatoi si nga RVB dhe nga vizita në institucion që stafi përdor dhe platformat të tjera apo emaile zyrtare si metoda interaktive për komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe shpërndarjen e materialeve ndihmese dhe programet e lëndëve.</p> <p><i>Platforma Pitagora</i> <i>Vizita në Institucion</i> <i>A.4.86. Guida e portalit për stafin akademik/Guida e portalit për studentët</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Platforma PITAGORA është sistemi që mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna për stafin dhe studentët e KUB, GVJ konstatoi se sistemi i brendshëm i menaxhimit ka platforma si “Portali” që mundësojnë forma komunikimi interaktiv midsi studentëve dhe stafit akademik.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Platforma Pitagora</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të KUB garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të KUB jepen dhe publikohet në gjuhën shqipe i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p>

	websit-in e KUB			
Konkluzione	<i>KUB përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë kolegjit. Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të KUB. Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet etj të KUB publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet në gjuhën shqipe.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstatoi nga RVB se KUB akordon një buxhet vjetor në përputhje me nevojat, bazuar në programin financiar ku është përcaktuar gjithashtu plani për mbarëvajtjen e programit të studimit. Buxheti vjetor dhe ai afatmesëm tre vjeçar, hartohet në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar, rregullave të kërkuara ne Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, në Ligjin Nr. 9901, date 14. 4. 2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në Ligjin Nr. 9228, date 29.4.2004” Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre, akteve normative të “Kolegjit Universitar i Biznesit KUB” si dhe strategjisë së Zhvillimit Institucional. Zyra e financës në KUB paraqet në SA raporte për realizimin e buxhetit të KUB, ku përfshin edhe kostot e DSLA si njësi bazë përgjegjëse për programin “Hoteleri-Turizëm”. Kjo zyrë ndjek në vazhdimësi planin për mbështetjen financiare të nevojshme të programit të studimit. Në buxhetin për vitin 2024 krahas fondeve për pagat e personelit dhe ato operative, janë parashikuar fonde edhe për akreditimin/riakreditimin, ku përfshihet edhe ky program studimi. Gjithashtu në KUB zë i rëndësishëm për IAL-në është kërkimi shkencor. Fondi

	<p>për këtë zë është parashikuar 5.48% e totalit të shpenzimeve vjetore.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Kopje e relacionit për realizimin e treguesve financiarë, dokumenti nr. 18; Raporti Vjetor i KUB, dokumenti nr.23, fq. 63-64</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ konstatoi nga RVB se struktura e programit financiar bëhet duke i ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimeve sipas drejtimeve, në të cilin ato do të përdoren. Burimet financiare të institucionit hartohen duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe shkencore të tij, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse të shpërndarjes së tyre. KUB harton plan buxhetin si IAL në nivel të detajuar si njësi kryesore dhe njësi bazë për programet e studimit. Në planet vjetore të buxhetit përfshihen edhe financimi i burimeve njerëzore që përdoren për realizimin e programit të studimit “Hoteleri - Turizmi”.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Kopje e relacionit për realizimin e treguesve financiarë, dokumenti nr. 18; Raporti Vjetor i KUB, dokumenti nr.23, fq. 63-64</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Referuar RVB KUB auditohet çdo vit nga kompani auditimi ndërkombëtare si Grant Thornton, me të cilën prej 7 vitesh vlerësohet dhe dokumentohet gjendja e financimit dhe efektivitetit financiar i institucionit. Raportet e Auditit dhe pasqyrat financiare të KUB diskutohen në mbledhjen e zgjeruar të Bordit të Administrimit ku përcaktohen detyrat për përmirësimin e treguesve financiar të KUB dhe Depozitohen e publikohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB)</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>A. 4.87, Kopje e raportit të auditit, (raporti Grand Thornton)</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ konstatoi nga RVB se KUB ka të dokumentuara raportet financiare. Në analizën për realizimin e buxhetit në SA, Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar (ZPRF) raporton për realizimin e treguesve të buxhetit në tërësi për institucionin. Gjatë diskutimeve evidentohen edhe problematikat që dalin për mbështetjen financiare të programeve të studimeve.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>A. 4.88, Kopje e relacionit për realizimin e treguesve financiarë</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi nga RVB se Situata financiare dhe bankare e KUB dëshmon se ka qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Gjithashtu kapacitetet financiare janë të mjaftueshme për përmirësimin e mëtejshëm dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>A. 4.89, Relacion mbi plan buxhetin për vitin 2024 dhe ai perspektiv deri në vitin 2025</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUB harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel institucioni dhe njësie bazë dhe bën analiza financiare në nivel njësie bazë. Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm dhe raportet përcillen nga Senati dhe Bordi i Administrimit deri në njësinë bazë. Situata financiare dhe bankare e KUB dëshmon dhe garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

			X	
--	--	--	---	--

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Mbëshetur në dokumentin në dispozicion, opinioni i marrë nga stafi i IAL-së dhe vëzhgimet gjatë vizitës në institucion krijohet bindja se KUB harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatorë. KUB ka tashme të hartuar, miratuar dhe konsoliduar lani për zhvillimin strategjik, Statut, Rregullore (IAL, njësie kryesore, program studimi). Këo aspekte garantojnë ligjshmëri në vazhdimësi në kuadër të ligjit të Arsimit të Lartë (80/2015)</p> <p><i>Dok. nr.5 Plani për zhvillimin strategjik të KUB, 2021-2026.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.2 Rregullore e Kolegjit Universitar Te Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.4 Rregullore e Departamentit të studimeve të Larta Administrative.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.7 Rregullore e programit të studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Krahas dokumentave të tjerë, në nenet 57 dhe 61 të Satutit të KUB qartësohet ky aspekt. Po ashtu, në rregulloren e programit të studimit, neni 6, përshkruhen procedurat e pranimit dhe regjistrimit.</p> <p><i>Dok. nr.5 Plani për zhvillimin strategjik të KUB, 2021-2026.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.2 Rregullore e Kolegjit Universitar Te Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.4 Rregullore e Departamentit të studimeve të Larta Administrative.pdf</i></p>

	<i>Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	<p>Ky aspekt theksohet në Statut, në nenin 61 pika 1 dhe 2 ku përcaktohen qarte pranimet dhe kriteret e pranimeve në programet profesionale. Mbështetur në dokumentin e ekzaminuar rezulton se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar te Biznesit.pdf</i> <i>A.5.95 Shkresë e KUB për MAS për kuotat e vitit akademik 2023-2024.pdf</i></p>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>Elementët e këtij kritri janë qartësisht të evidentuara në rregulloren e programit të studimit. Lehtësia në të kuptuarit dhe të aksesimit të elementëve të këtij kritri garantohet nëpërmjet aktivitetve dhe kanaleve të komunikimit të ndryshme. Së pari, promovimet pranë shkollave të mesme për maturanët, është një mënyrë e komunikimit të këtyre kritereve, me fokus të vecanë, kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve. Në vijim, përgjatë zhvillimit të mësimit me studentët e regjistruar në këtë program studimi informohen me fletëpalosje dhe në menyre verbale rreth përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Në vazhdim, elementët e këtij kritri publikohen në ëëbsite të IAL-së si edhe media sociale e IAL-së.</p> <p><i>Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar te Biznesit.pdf</i> <i>Dok. nr.2 Rregullore e Kolegjit Universitar Te Biznesit.pdf</i> <i>Dok. nr.4 Rregullore e Depatamentit te studimeve te Larta Administrative.pdf</i> <i>Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i> <i>A.5.95 Shkresë e KUB për MAS për kuotat e vitit akademik 2023-2024.pdf</i></p>
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të	<p>Mbështetur në dokumentin e dorëzuar, vërtetohet se KUB ka procedura të konsoliduara lidhur me këtë aspekt. Sikundër kërkohet nga kuadri ligjor, KUB në çdo vit akademik i dërgon shkresë MAS për kuotat e vitit akademik. Po ashtu, ky aspekt është i parashikuar në statut dhe rregullore të programit të studimit. Në nenet 5 dhe 6 të rregullores së</p>

<p>veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>programit të studimit ky IAL harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret baze dhe ato shtesë për përzgjedhjen e kandidatëve, përfshirë dhe ata me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p><i>Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar te Biznesit.pdf</i> <i>Dok. nr.2 Rregullore ë Kolegjit Universitar Te Biznesit.pdf</i> <i>Dok. nr.4 Rregullore e Depatamentit te studimeve te Larta Administrative.pdf</i> <i>Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i> <i>A.5.95 Shkresë e KUB për MAS për kuotat e vitit akademik 2023-2024.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentin e dorëzuar (raportin e veprimtarisë financiare 2022-2023) verifikohet se ky kriter plotësohet. Cdo vit akademik Senati dhe Bordi i Administrimit miraton politikat dhe masat për bursa për studentët. Politika e bursave të këtij institucioni është mbi bazë të kriterëve si vijon: burse e plotë për studentë që kanë mesatare mbi 9.5, gjysem burse për studentë me mesatare 8.5-9.4, dhe reduktim tarife deri në 25% për ata që kanë arsye sociale (të semure, afesi te veçanta, jetim etj.).</p> <p><i>Dok. nr.18 Relacion per realizimin e treguesev financiare.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Mbështetur në dokumentacionin e ekzaminuar si edhe nga intervistimi i safit përgjatë vizitës në IAL, rezulton se ky IAL harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. Në vazhdim, ky IAL, ka politika dhe procedura të dedikuara lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, si edhe të ndihma/bursa për shtresat në nevojë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Institucioni ka hartur një sërë rregulloresh në nivel institucional, rregullore programesh si dhe rregullore të posaçme që i referohen aspekteve të përparimit akademik deri në diplomimin e studentëve. Këto rregullore përmbajnë informacion të detajuar që përfshin të gjithë ciklin akademik, përfshirë edhe kriteret e pranimit në programin e studimit.</p> <p>Një burim i rëndësishëm informacioni janë edhe planet mësimore dhe sylabuset e lëndëve të cilët përmbajnë të gjithë komponentët e nevojshëm informativë si kohëzgjatjen e lëndës, detyrimet që studentët duhet të përmbushin në raport me lëndën, si dhe kriteret e vlerësimit. Studentët marrin informacione të tilla që në javën e parë të vitit akademik nëpërmjet prezantimit nga pedagogët e lëndës, si dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së vitit akademik. I gjithë informacioni i nevojshëm mund të aksesohet edhe në faqen web të institucionit.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i> <i>A.5.92 Guida studentore Fletë palosje.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Mbështetur në rregulloren e ekuivalentimeve ky kriter plotësohet në aspektin e një procedure të konsoliduar. Janë përcaktuar procedurat, detyrimet që kanë studentët si dhe dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin si vërtetimi i vlerësimeve të marra, sylabuset e lëndëve të zhvilluara, vërtetimi i çregjistrimit nga institucioni i mëparshëm etj. Informimi rezulton që kryhet nëpërmjet fushatave të drejtpërdrejta me studentët, media sociale, eëbsite.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i> <i>A.5.94 Rregullore e njohjes dhe ekuivalentimit të studimeve në KUB.pdf</i> <i>A.5.92 Guida studentore Fletë palosje.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e</p>	<p>Në sullabuset, rregulloren e programit të studimit Informimi rezulton që kryhet nëpërmjet fushatave të drejtpërdrejta me studentët, media sociale, website. Fushatat e drejtpërdrejta</p>

<p>vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>zhvillohen duke komunikuar ballë-për-ballë me maturantët e shkollave të msme, dhe sudentë në auditorë në IAL (studentët e regjistruar tashmë), duke përdorur mjetin e fletëpalosjeve. Po ashtu, këo informacione janë pjesë e përmbajtjes së syllabuseve, nëpërmjet të cilave sstudentytët njihen nga ana e stafitk akademik (në fillim të vitit akademik) për aspekte të këtij kriteri. Në vijim, këto elementë të këtij kriteri pasqyrohen në menyre të vazhdueshme në media sociale, ëebsite të IAL-së.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i> <i>A.5.92 Guida studentore Fletë palosje.pdf</i> <i>A.2.27 Syllabuse të lëndëve të semestrit të parë të vitit akademik 2023-2024 në programin "Hoteleri-Turizëm"..pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>. Informimi rezulton që kryhet nëpërmjet fushatave të drejtpërdrejta me studentët, media sociale, ëebsite.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i> <i>A.3.62 Udhëzim i drejtuesit të njësisë kryesore "Për Procedurat e Zhvillimit të Provimit të Diplomimit në Programet.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Informimi rezulton që kryhet nëpërmjet fushatave të drejtpërdrejta me studentët, media sociale, website.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i> <i>A.5.92 Guida studentore Fletë palosje.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Mbështetur në dokumentacionin e disponueshëm krijohet bindja se IAL-ja informon studentët e programit të studimit informacionin e nevojshëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Mbështetur në intervistimin e safi gjatë vizitës, procedurat e përcaktuara në Statut, rregullore të programit etj, informimi rezulton që kryhet nëpërmjet fushatave të drejtpërdrejta me studentët, media sociale, website. Staf i departamenti dhe i strukturave të tjera të IAL angazhohen në këtë drejtim.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i></p> <p><i>A.5.97 Kopje e prezantimit të përgjegjës të DSLA me studentët e vitit të parë.pdf</i></p> <p><i>A.5.98 Struktura mësimore e KSLP për vitin akademik 2022-2023 dhe 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>A.5.92 Guida studentore Fletë palosje.pdf</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Guida studentore, ëebsite, dhe afishimet në ambiente të IAL-së përbëjnë burimin e informacionit dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i></p> <p><i>A.5.92 Guida studentore Fletë palosje.pdf</i></p> <p><i>A.5.97 Kopje e prezantimit të përgjegjës të DSLA me studentët e vitit të parë.pdf</i></p> <p><i>A.5.98 Struktura mësimore e KSLP për vitin akademik 2022-2023 dhe 2023-2024.pdf</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Nëpërmjet funksioneve të ZSKK adresohet ky kriter. Megjithatë, krahas qartësisë së funksioneve sikundër tregohet në rregulloren e ZSKK, nga intervistimi i stafit gjatë vizitës në IAL, nuk krijohet bindja se realizohen trajnime të studentëve lidhur me zhvillimin e karrierës, siç është ndërtimi i një CV, sjellja në intervista pune etj. Staf i përcaktuar në këtë strukturë drejtuese nuk ka kualifikimin e duhur dhe në përputhje me kompetencat e kërkuara.</p>

	<p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i></p> <p><i>A.5.99 Kopje e emailit të Confindustria Italiane në Shqipëri.pdf</i></p> <p><i>A.5.100 Kopje e marrëveshjes së bashkëpunimit me kompaninë MeliâKopje e linqeve që DSLA u ka dërguar.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Guida studentore, website, dhe afishimet në ambiente të IAL-së përbëjnë burimin e informacionit të mjaftueshëm për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i></p> <p><i>A.5.92 Guida studentore Fletë palosje.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikën profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e disponueshëm, rezulton se IAL ka një listë me aktorë të tregut. Marrëveshjet e bashkëpunimit me aktorë të tregut, procedura e konsoliduar, tutoriazi i dedikuar, krijojnë bindje se ky kriter arrihet plotësisht.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i></p> <p><i>A.5.92 Guida studentore Fletë palosje.pdf</i></p> <p><i>Dok. nr.15 Lista e partnereve të DSLA për praktikën profesionale për vitin akademik 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>A.2.39 Lista e miratuar e Drejtorit të KSLP për pedagogët tutorë të praktikës profesionale.pdf</i></p> <p><i>A.5.99 Kopje e emailit të Confindustria Italiane në Shqipëri.pdf</i></p> <p><i>A.1.20 Paketa e Praktikës Profesionale.pdf</i></p> <p><i>A.5.107 Statuti i KUB, neni 74 Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës Guida studentore.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Krahas arritjes së një sërë kriteresh sic janë vënja në dispozicion të informacioneve për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të nxënies dhe mundësitë e punësimit, nga ana tjetër, ky IAL nuk garanton një kontribut në zhvillimin e karrierës së studentëve, gjë që realizohet nëpërmjet trajnimeve të studentëve lidhur me këtë aspekt (p.sh., ndërtimi i një CV, sjellja në intervista pune etj.)</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi									
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Edhe pse ka procedurë të konsoliduar për të dhënat statistikore të studentëve, ende nuk ka një sistem informatik të konsoliduar për menaxhimin e informacionit, gjë e cila do të garantonte siguri, lehtësi në verifikim, dhe transparencë. Megjithatë, KUB është në proces implementimi të sistemit PITAGORA. Megjithatë, kjo nuk përbën pengese në mbarëvajtjen normale të procesit. Numri i studentëve të regjistruar sipas profileve është:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Hoteleri</th> <th>Agjenci Udhëtimesh</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022 - 2023</td> <td>6</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>2023 - 2024</td> <td>7</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i></p>	Viti akademik	Hoteleri	Agjenci Udhëtimesh	2022 - 2023	6	0	2023 - 2024	7	3
Viti akademik	Hoteleri	Agjenci Udhëtimesh								
2022 - 2023	6	0								
2023 - 2024	7	3								
<p>Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga takimi me stafin e IAL-së gjatë vizitës në këtë institucion rezulton se nuk ka një sistem informatik të brendshëm. Edhe pse ka procedurë të konsoliduar për të dhënat statistikore të studentëve, nuk ka një sistem informatik për menaxhimin e informacionit, gjë e cila do të garantonte siguri, lehtësi në verifikim, dhe transparencë. Megjithatë, kjo nuk përbën pengese në mbarëvajtjen normale të procesit.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i> https://kub.edu.al/</p>									
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse</p>	<p>Mbështetur në rregulloren e KUB, nëpërmjet raporteve vjetore të IAL-së, KUB, vlerëson gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me veprimtarinë e studentëve dhe menaxhimin e tyre. Gjithashtu</p>									

<p>për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>rezultton se, nëpërmjet raporteve të akreditimit institucional apo edhe ai i programeve të studimit, kryhet ky proces që lidhet me studentët.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i> <i>A.5.103 Raporti Vjetor i DSLA për vitin akademik 2022-2023.pdf</i> <i>Dok. nr.2 Rregullore e Kolegjit Universitar Te Biznesit.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Mbështetur në raportin vjetor të DSLA për 2022-2023 KUB, vlerëson në mënyrë periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve.</p> <p>Megjithatë, lidhur raportet analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në dalje të studentëve nuk ka pasi ky është një program studimi i çelur rishtaz.</p> <p><i>Nga takimi me stafin e IAL-së;</i> <i>A.5.103 Raporti Vjetor i DSLA për vitin akademik 2022-2023.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni nëpërmjet sekretarisë mësimore, dokumenton dhe administron në mënyrë të rregullt të gjithë informacionin dhe dokumentacionin me të dhënat e studentëve që ndjekin këtë program studimi nga momenti i regjstrimit deri në diplomim.</i></p> <p><i>Sugjerohet që sisemi PITAGORA që është në proces të vihet në punë sa më shpejt të jetë e mundur i cili do të lehtësohte menaxhimin e të dhënave dhe informacionit për studentët, gjë e cila do të garantonte siguri, lehtësi në verifikim, dhe transparencë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e

përmirësimin të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Në mbështetje të Statutit dhe intervistave përgjatë vizitës në ambientet e IAL-së, rezultoi se studentët përfaqësohen në Senat, në NJSBC, dhe nëpërmjet vet-organizimeve në këshilla studentore. Në nivel institucional një nga strukturat e KUB është edhe Zyra e Studentëve dhe e Këshillimit të Karrierës, e cila përveç të tjerash, mban lidhje të vazhdueshme me këshillat studentore si dhe drejton procesin e këshillimit të studentëve. Pranë KUB ngrihet dhe funksionon qeveria studentore e cila përfaqëson zërin dhe interesat e studentëve në proceset vendimmarrëse.</p> <p><i>Nga takimi me stafin dhe studentët e IAL-së;</i> <i>A.5.104 Vendimi i Senatit për pjesëmarrjen si anëtar i Senatit i përfaqësuesit të studenteve.pdf</i></p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, garantohej në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 46, pika 6, si edhe në Statutin e KUB. Kështu, studentët janë të përfaqësuar në Senat, në NJSBC, dhe nëpërmjet vet-organizimeve në këshilla studentore. Neni 80/1/d i Rregullores së KUB parashikon të drejtën e studentëve për të shprehur vlerësimin e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies dhe personelit.</p> <p><i>Nga takimi me stafin dhe studentët e IAL-së;</i> <i>A.5.105 Urdhëri të Rektorit për pjesëmarrjen e studentëve në GVB (2).pdf</i> <i>A.5.104 Vendimi i Senatit për pjesëmarrjen si anëtar i Senatit i përfaqësuesit të studenteve.pdf</i></p>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e	<p>Bazuar në grupin e punës së akreditimit të këtij program studimi, si edhe nëpërmjet vëzhgimit të vazhdueshëm të opinionëve të studentëve (me anë të pyetësorëve për çdo semestër) rezultoi se ky kriter përmbushet. Megjithatë, duhet theksuar se ëshë ende herët të flitet për procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit sepse ai ëshë i çelur rishtazi.</p>

tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	<i>Nga takimi me stafin dhe studentët e IAL-së;</i> <i>A.5.106 Mendime të studentëve të programit të studimit "Hoteleri-Turizëm" mbi kurrikulën dhe syllabuset e lëndëve.pdf</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Sikundër tregohet dhe në kriterin e mëipërm (Kriteri 3), si edhe mbështetur në dokumentacionin e disponueshëm dhe intervistat me studentët, mundësia e dhënies së mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës, garantohet në rregulloren e programit të studimeve. <i>Nga takimi me stafin dhe studentët e IAL-së;</i> <i>Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i>			
Konkluzione	<i>Mbështetur në analizën e dokumentacioni në dispozicion dhe intervistimi të stafi dhe studentëve, krijohet bindja se KUB përfshin dhe angazhon në mënyrë aktive studentët lidhur me përmirësimin e cilësisë në procesin mësimorë. Lidhur me përmirësimet e mundshme të programi të studimit, duhet theksuar se ëshë ende herët të flitet për këtë aspekt, sepse ky program ëshë i çelur rishtazi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet	Në funksion të jetësimit të kësaj politike dhe zbatimin e procedurave për këtë qellim, KUB ka strukturat të dedikuara për këtë qellim. Kështu, KUB zyrën e studentëve dhe këshillimi të karrierës. Me një staf administrativ me kohë të plotë.

<p>ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p><i>A.5.107 Statuti i KUB, neni 74 Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës Guida studentore.pdf</i> <i>Dok. nr.1 Statuti i Kolegjit Universitar te Biznesit.pdf</i> <i>Dok. nr.2 Rregullore ë Kolegjit Universitar Te Biznesit.pdf</i> <i>Dok. nr.4 Rregullore e Depatamentit te studimeve te Larta Administrative.pdf</i> <i>Dok. nr.7 Rregullore e programit te studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>IAL ka një rregullore dhe strukturë të dedikuar për këtë aspekt. Megjithatë, nga intevistimi i stafit të zyrës së studentëve dhe këshillimi të karrierës rezulton jo e vazhdueshme lidhur me këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p><i>Nga takimi me stafin dhe studentët e IAL-së;</i> <i>A.5.107 Statuti i KUB, neni 74 Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës Guida studentore.pdf</i> <i>A.5.107 Statuti i KUB, neni 74 Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës Guida studentore.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Krahas qartësisë së funksioneve sikundër tregohet në rregulloren e ZSKK, nga dokumentacioni i disponueshëm nuk krijohet bindja se realizohen trajnime të studentëve lidhur me zhvillimin e karrierës, siç është ndërtimi i një CV, sjellja në intervista pune etj.</p> <p><i>Nga takimi me stafin dhe studentët e IAL-së;</i> <i>A.5.107 Statuti i KUB, neni 74 Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës Guida studentore.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të</p>	<p>Nga analiza e dokumentacioni të disponueshëm kriter parashikohet, si edhe ka një strukturë të dedikuar për këtë aspekt. Ndërkohe, është e udhës të theksohet fakti se është ende herët të flitet për këtë aspe, sepse ky program është i çelur rishtazi dhe nuk ka të diplomuar ende. Megjithatë, nuk</p>

programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	<p>rezulton te ketë një procedurë dhe dokumentacion që siguron gjurmimim e studenëve mbas diplomimit të tyre.</p> <p><i>Nga takimi me stafin dhe studentët e IAL-së;</i></p> <p><i>A.5.107 Statuti i KUB, neni 74 Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës Guida studentore.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Kjo IAL ka procedura e struktura të dedikuara për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave te tyre. Megjithatë, nga analiza e dokumentacioni të disponueshëm nuk krijohet bindja se IAL ka një procedurë të miratuar e shoqëruar me një dokumentacion të nevojshme që të ndjek studentët pas diplomimit, mbledhë, përpunojë dhe të mbajë të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit. Për më tepër, nga dokumentacioni i disponueshëm nuk krijohet bindja se realizohen trajnime periodike të studentëve lidhur me zhvillimin e karrierës së tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional ne “Hoteleri-Turizëm” në profilet “Agjenci Udhëtimesh” dhe “Hoteleri”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar i Biznesit”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Marrëdhënie më aktorë të tregut që lehtësojnë punësimin e të diplomuarve dhe për rrjedhojë, rritjen e vlerës së diplomës;
2. Është program studimi që synon ofrimin e kapaciteteve njerëzore në një sektor me rritje eksponenciale. Është program studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare;
3. Procesi i informimit të maturantëve është kapilarë dhe me ndikim në regjistrimet e reja;
4. Strukturat akademike dhe administrative si dhe procese të konsoliduara që lehtësojnë mbarëvajtjen e programi të studimit.

Pika të dobta

1. Procesi i mbështetjes së studentëve duhet të jetë më konkret dhe kapilarë, sidomos në aspektin e informatizimit të shërbimit ashtu edhe në atë të këshillimit të karrierës;
2. Kualifikimet e mëparshme të stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie nuk përputhet plotësisht me lëndët e profileve të programit;
3. Struktura e kurrikulës nuk garanton vazhdimësi në formimin e studentëve.

Rekomandime:

1. Procesi i mbështetjes së studentëve në aspektin e këshillimit të karrierës, më konkretisht, krijimi i dosjeve të studentëve që trajnohen për proceset e kërkimit për punësim (CV, letër motivim, intervista e punës etj.) do të ishte me vlerë;
2. Në afatin e shkurtër dhe të mesëm, nevojitet përqëndrim dhe mbështetje konkrete në kualifikimet e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, në mënyrë që të pasurohet edhe më tej profili i tyre dhe të jetë në përputhje plotësisht me lëndët e programit. Mbështetja të jetë në hulumtim, projekte, mobilitete stafi, post-doktoratura etj;
3. Struktura e kurrikulës duhet ndërtuar për të garantuar vazhdimësi në formimin e studentëve. Ka nevojë të ri-organizohet dhe përmbajtja e disa lëndëve të thellohet, qartësohet dhe shmangen ngjashmëritë.
4. Në funksion të praktikës që KUB bën referuar orëve të hapura me personalitete. GVJ pasi konstatoi në dokumentacionin që shoqëron RVB në, rekomandon që në të ardhmen në praktikën që institucioni bën. Në lidhje me leksionet e hapura dhe

pasurimin e auditorit me personalitete të spikatur të profilit, të programit studimit “Hoteleri-Turizëm”. Të ftohen pikërisht personalitete të shquara të cilët janë të profilit të Turizmit në përgjithësi dhe Hotelierisë në veçanti.

5. Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi në dokumentacionin paraprak por edhe atë shtesë që shoqëron RVB në, nevojën për të rekomanduar që në të ardhmen në përmbajtje të syllabuseve të lëndëve të pasurohet me literaturë bazë të përditësuar e të viteve të fundit.
6. Gjithashtu të evitohen e shmangjet mbivendosje temash apo literature nga lëndë të tjera. Rasti i temave e i literaturës së përsëritur të librit, Ekonomia e Turizmit në përmbajtje të syllabusit Politika Turistike (kujtojmë se vet Ekonomi Turizmi është lëndë në kurrikulën e këtij programi studimi).
7. Rekomandojmë strukturën drejtuese të KUB, të konsiderojë rekrutimin e burimeve njerëzore staf akademik efektiv PAE me background dhe fushat akademike-kërkimore Turizmi dhe Hotelierie
8. Rekomandojmë strukturën drejtuese të KUB, të inkurajojnë me instrumenta të ndryshëm diktues Stafin efektiv PAE të këtij programi. I cili është aktualisht i angazhuar me lëndë të rëndësishme të kurrikulës së programit të studimit programit të studimit 2 vjeçar “Hoteleri-Turizëm”. Të cilët në backgroundin e vet, si në bachelor apo edhe në nivel Masteri Shkencor nuk janë në përputhshmëri me drejtimin “Hoteleri-Turizëm”. Duhet që drejtimin e tyre në studimet që po ndjekin në vazhdim në nivel Doktorature apo edhe post Doktorature. Ta kenë në drejtim të profilit “Hoteleri-Turizëm”. Si pasojë edhe aktivitetin e tyre kërkimor e shkencor ta kenë në këtë drejtim. Shkas i këtij sygjerimi janë disa pedagogë të stafit akademik efektiv PAE të cilët nuk janë në përputhshmëri me profilin “Hoteleri-Turizëm” por që kanë mundësi të orjentojnë në vijim studimet e tyre dhe fushën e tyre të kërkimit në drejtim të profilit të “Hoteleri-Turizëm”. Fakt ky i cili ndikon drejt drejtpërdrejtë në cilësinë e këtij programi studimi.
9. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon një përditësim më dinamik të literaturës së viteve të fundit dhe sa më bashkëkohore. Gjithashtu të sigurohet literature specifike sipas lëndëve.

Evaluation's conclusions for the professional study program "Hotel-Tourism" provided by the Higher Education Institution "Kolegii Universitar i Biznesit"

Strengths and affirmations:

1. Better market relations that facilitate employment of graduates, and therefore, increase the value of the degree;
2. It is a study program aimed at providing human capacities in a sector with exponential growth. It is a study program in accordance with institution's mission and purpose, with the academic field of the Faculty and department unit responsible for the study program, and which aims to preserve national interests and values;
3. The process of informing graduates is capillary and has an impact on new registrations;
4. Academic and administrative structure as well as consolidated processes facilitate the smooth running of the study program.

Weaknesses

1. The process of supporting students should be more concrete and capillary, especially in the aspect of computerization of the service as well as in that of career counseling;
2. The previous qualifications of the academic staff engaged in teaching do not fully match the subjects of the study program profiles;
3. The structure of the curriculum does not guarantee continuity in the capacity building of the students.

Recommendation

1. The process of supporting students in terms of career counseling, more specifically, creation of students' files of those who are trained for the job search processes (CV, cover letter, job interview, etc.) could be value added;
2. In the short and mid-terms, concrete focus and support is needed on the qualifications of the academic staff engaged in teaching, in order to further enrich their background and to be compatible with the study program courses. The support should be in research, projects, staff mobility, post-doctorate, etc;
3. The structure of the curriculum must be built to guarantee continuity in the formation of students. There is a need to re-organize and deepen the content of some subjects, clarify and avoid similarities.
4. In function of the practice that University College of Business UCB/KUB makes referring to open hours with personalities. External evaluation group EEG/GVJ after ascertaining in the documentation that accompanies the internal evaluation report

IEE/RVB, recommends that in the future in the practice that the institution does. In relation to the open lectures and enrichment of the audience with outstanding personalities of the "Hospitality-Tourism" study program. Prominent personalities who are from the profile of Tourism in general and Hospitality in particular should be invited.

5. The external evaluation group found in the preliminary documentation as well as the additional documentation that accompanies the RVB, the need to recommend that in the future the content of the course syllabuses be enriched with updated basic literature of recent years.
6. Overlapping topics or literature of the book, Tourism Economy in the content of the Tourism Policy syllabus (remember that Tourism Economy itself is a subject in the curriculum of this study program).
7. We recommend the management structure of University College of Business UCB/KUB to consider the recruitment of human resources, effective academic staff EAS/PAE with background and academic-research fields Tourism and Hospitality
8. We recommend the management structure of University College of Business UCB/KUB to encourage the effective academic staff EAS/PAE with various dictating instruments. Who is currently engaged in important subjects of the curriculum of the 2-year study program "Hospitality-Tourism". Those who in their background, such as at the bachelor's or even Master of Science level, are not compatible with the "Hospitality-Tourism" direction. It is necessary to guide them in the studies they are currently pursuing at PhD/Doctoral or even post PhD/Doctoral programs. Have It in the direction of the profile "Hospitality-Tourism". As a consequence, their research and scientific activity should also be in this direction. The reason for this suggestion is some lecturers of the effective academic staff EAS/PAE who are not compatible with the profile "Hospitality-Tourism", but who have the opportunity to further orient their studies and their field of research in the direction of the profile of "Hospitality-Tourism".
9. The external evaluation group recommends a more dynamic update of the literature of recent years and as contemporary as possible. Also provide specific literature according to subjects.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X


